

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7323 E diel 15 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës
Pragreforma e sistemit ligjor dhe reformat e tjera të rëndësishme ekonomike, që pritet të vihen në zbatim in extremis në realitetin shqiptar, ndonëse kanë ...
Vijon në faqen 21

Nga ELVIS ZAIMI
Reformat, sfera publike dhe riorientimi i vlerave


Opinion i Ditës
Cili është komplimenti që ju ka Cmbetur më gjatë në mendje, që ju ka pëlqyer më shumë, që do veçonit nga të tjerët? Cili është komplimenti...
Vijon në faqen 22

Nga VALBONA NATHANAILI
Bisedë rreth komplimentit



Lista/ 9 dokumentet për të marrë tapinë

Procedura, si bëhet regjistrimi i pronave në zonat rurale, ja kostot

Aplikimi në "e-Albania", dokumentet që duhen për të regjistruar çdo ndërtime në fshatra

Nga ORNELA MANJANI

Regjistrimi i pronave në zonat rurale do të kryhet përmes portalit e-albania dhe ka një kosto prej 30 mijë lekësh. Në të njëjtin portal mund të aplikojnë për certifikatën e pronësisë edhe personat ...
Në faqen 6

KRYEMINISTRI: SHEFAT E KOMISARIATEVE DREDHIN ZINXHIRIN E PINE RAKI

EDI RAMA PARALAJMERON SHKARKIMIN E PREFEKTEVE

Mbledhja me vendorët në Vlorë, Rama: Mos printoni më certifikata, po e bëtë do i paguani nga xhepi. Prefektët i shohim në TV vetëm për përmbytje



(Në foto) Kryeministri Edi Rama gjatë një konsultimi publik për Buxhetin 2018 me qytetarë në Vlorë

KRYETARI I PD

Basha, ftesë për ndërkombëtarët: Nxirrni emrat e kriminelëve
Në faqen 2

DEPUTETI I LSI

Petrit Vasili: Shqipëria po shembet në duart e kriminelëve
Në faqen 3

MINISTRJA E KULTURES

Mirela Kumbaro: "Butrinti", jam gati të përballem me prokurorinë
Në faqen 11

MEDIA E HUAJ

"Vogue" shkruan reportazh për Tiranën: Një vorbull pulsuese
Në faqen 10

"MILOSAO"
Monumentet e REALIZMIT SOCIALIST e dhunuan peizazhin...
Maks Velo:
Monumentet e soc-realizmit e përdhunuan imazhin
Suplement

Dëshmitë/ Zamir Latifi tentoi të kundërpërgjigjej i plagosur, u vra nga Laert Haxhiu

Rindërtohet skema/ Si u krye masakra e Lushnjës

Atentati me 2 të vranë e 2 të plagosur, lihet i lirë "Juli i Pashakos"

Nga KLODIANA LALA & TRËNDAFILE VISHA
Zamir Latifi mbase do i kishte shpëtuar masakrës së ndodhur pasditen e 11 tetorit në vendin e quajtur "Ura e Përroit" në qendër të qytetit të Lushnjës nëse nuk do të kishte nxjerrë pis-



Jurger Hoxha



Zamir Latifi

toletën për të qëlluar Laert Haxhiun, i cili po tentonte të hynte në lokalin bar-kafe për të ekzekutuar shë-njestrën e tij, Xhulio Shkurtin. Mësohet se 26-vjeçari Latifi ishte i plagosur në këmbë kur ka tentuar t'i kundërpërgjigjet autorit të atentatit ...
Në faqen 7



Mbledhja, paralajmërimi për shefat e komisarivateve që dredhin zinxhirë e pinë raki

Reformimi, Rama: Shkarkimet së shpejti, skuadër e re prefektësh

"Skanim administratës, 10 ditë kohë ministrave"

Nga Vlorë Kryeministri Edi Rama paralajmëroi ndëshkime përmasive për shërbëtorët e administratës së pushtetit qendror në këtë qark. Kryeministri Edi Rama, u përqendrua te situata me kriminalitetin, ndërsa paralajmëroi për masa ndëshkuese policët, që sipas tij mbyllin sytë para këtij fenomeni. Me tone të forta, Rama paralajmëroi masa ndëshkuese për çdo punonjës të policisë së shtetit, që sipas tij mbyll sytë para kriminimit. "Mbyllja e syve duhet ndëshkuar me pezullim dhe madje edhe me ndjekje penale për ata punonjës të Policisë së Shtetit, për ata drejtues të Policisë së Shtetit, për ata shefa komisarivate që dredhin zinxhirë dhe pinë raki ndërkohë që pas shpinës së tyre, të kthyer me qëllim nga ana tjetër, trupit dhe sytë zhvillohen krime të tilla", -deklaroi z.Rama. Qeveria zhvilloi për dy ditë me radhë takime në Vlorë, ndërsa Kryeministri kërkoi nga administrata një skanim të të gjitha burimeve njerëzore për të evidentuar personat më të përgatitur dhe më të aftë në radhët e institucioneve. "Një raport i detajuar i të gjitha burimeve njerëzore në këtë këndvështrim duhet përgatitur dhe duhet dorëzuar nga secili prej jush, nga çdo drejtori këtu në qarkun e Vlorës, po sigurisht do ta kërkojmë dhe do ta marrim në gjithë Shqipërinë që t'i adresojmë këto çështje themelore, fundamentale, elementare, parimore një orë e më parë", theksoi kryeministri. Një tjetër pikë ku kreu i qeverisë është ndaluar ishte ajo certifikatave, për të cilat është urdhëruar ndalimi i prodhimit. Kryeministri u shpreh se qytetarët duhet t'i marrin në drejtoritë përkatëse certifikatat dhe punonjësit e bashkisë duhet të zbatojnë urdhrin e ministrit të Brendshëm. "Nuk e kuptoj pse prodhoni akoma certifikata, kur ministri ka nxjerrë një urdhër që të mos printojnë dhe paguajnë për certifikatat? Për çfarë i prodhoni certifikatat? Ju duhet t'i thoni qytetarit se mund ta nxjerrë edhe vetë dhe mos paguaj. Kijeni parasysh këtë. Do gjobisim punonjësit e bashkive që nxjerrin certifikata. Do i



Kryeministri Edi Rama

BATUTA

Gjatë një dreke në familjen e Viron Micit nga Kanina e Vlorës, mes batutave dhe thumbimeve, në bisedë e sipër, kryeministri Rama i njohu meritën për zgjedhjet më të qeta në histori edhe kryedemokratit Basha. Por, sipas tij, tashmë Bashën e rrëmbeu ankthi, pasi nuk ka stofin e liderit dhe iu kthye historisë së vjetër.

MUNGESA

PD kishte dy mungesa në seancën plenare të së premtes, deputetin Flamur Noka, të përjashtuar nga Kuvendi për 10 ditë dhe nënkryetari i Kuvendit, Edi Paloka. Ky i fundit teksa zbuloi se ishte i pranishëm në mbledhjen e Unionit Ndërparlamentar, ironizoi në "Fb": "Mungova dhe në sallën e Kuvendit për të qenë i pranishëm në një tjetër sallë, atë të Unionit Ndërparlamentar. Këtu nuk drejton Ruçi dhe përdorimi i kokainës është i ndaluar, sidomos për kryeministrat..."



Petrit Vasili

"Parlamenti i degraduar si në komunizëm"

LSI, Vasili: Shqipëria po shembet, po shket në duart e krimit

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, akuzoi kryeministrin Edi Rama, për situatën e keqe politike dhe ekonomike në të cilën ndodhet vendi. Vasili iu referua raportit të Këshillit Europian për Shqipërinë. Sipas Vasilit Shqipëria Republikë Parlamentare po shembet nga drejtimi asgjësues i parlamentit dhe nga kriminalizimi kryeministral. "Mediat europiane janë shumë të qarta, që kryeministri shkollëpak i këtij vendi me paaftësinë kriminale të tij dhe të atyre që i bëjnë fresk po e çon këtë vend në një greminë ekonomike dhe politike. Në parlamentin e degraduar që drejtohet me një servilizëm, që nuk është parë as në fillimet e pluralizmit po realizohet vetëm qetësimi i paranojave biologjike dhe politike të kryeministrin mendjehumbur në kurriz të parlamentarizmit. Po jetojmë skandalozisht parlamentin e partisë së punës dhe Shqipëria Republikë Parlamentare po shembet nga atavizmat e së shkuarës komuniste. Vendi po shket shumë treqzëshëm në duart dhe pushtetin e krimit dhe përgjegjësia për jetën e mijëra familjeve e bizneseve, është vetëm e një njeriu, e kryeministrin, i cili do që të ikë duke lënë zjarrin prapa. Ja ç'thotë media, Këshilli Europian për marrëdhëniet e jashtme: Shqipëria ka ndarje të thellë politike, ku politika dhe marrëdhëniet mes klaneve ndërthuren në një rrjet hakmarrje dhe korrupsioni. Trafikimi i drogës dhe pastrimi i parave po lulëzojnë në këtë vend. Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, në vend që t'i përgjigjet këtyre dështimeve të qeverisë, rishtazi e ka përqesuar gjendjen duke folur për Shqipërinë e Madhe", -shkruan z. Vasili në "Facebook".

"Kryeministri Rama merret me certifikatat"

PD, Shehaj: Shqipëria është si Kolumbia e "Narcos"

Deputeti i PD-së Agron Shehaj i kujtoi dje kryeministrin Edi Rama se ndërsa merret me certifikatat, amerikanët sjellin në Tiranë agjentët e DEA-s. Deputeti demokrat i qarkut të Vlorës akuzoi se Shqipëria është shndërruar si Kolumbia e serialit Narcos. "Shumë larg prej të qenit një vend evropian, Shqipëria i ngjan me shumë Kolumbisë të serialit Narcos. Përbërësit janë të gjithë: dominimi i drogës, vrasjet pothuajse të përditshme, qeveria e lidhur me krimin, policia e pafuqishme, ambasadorët e huaj që ju bëjnë presion dhe të vetëdijshëm që ju jeni të kapur me krimin, sjellin agjentët e tyre për të bërë atë punë



Deputeti i PD-së, Agron Shehaj

që ju nuk doni të bëni, njësoj si agjentët e DEA-s në Kolumbi. Vlonjatët dhe të gjithë shqiptarët duan punë, lëri shfaqjet, mjaft i mashtrave! Biznesi dhe inves-

timet e huaja sjellin mirëqenie. TVSH dhe persekutimi i bizneseve të vogla sjellin mjerim dhe fitime vetëm për miqtë e tu", -shprehet z. Shehaj.

paguajnë ata nga xhepi i tyre. Ne kemi bërë thirrje dhe prapë nxjerrin certifikata. Do detyrohemi të çojmë deri në fund këtë proces dhe do ta mbajmë paratë nga droga atyre punonjësve të bashkisë që vijojnë të nxjerrin certifikata dhe nuk zbatojnë urdhrat.", tha z.Rama. Nga ana tjetër, kreu i ekzekutivit ka bërë me dije se po punohet për një skemë të re të kontrollit mjedisor të vijës bregdetare. "Bashkitë do të vendosin gjo-ba të rënda për ndotësit e mjedisit", -ka paralajmëruar Rama. Sa i takon turizmit, ai

shtoi se po vijojnë investimet në gjithë vijën bregdetare. Pasditën e djeshme z.Rama pati një takim me drejtuesit vendorë dhe përfaqësues të bashkive të qarkut të Vlorës. Gjatë fjalës së tij, kreu i qeverisë paralajmëroi shkarkimin e prefekteve në 12 qarqet e vendit. Rama tha se do të ketë ndryshime edhe në këtë drejtim, në mënyrë që edhe këto institucione të pushtetit vendor të jenë më funksionale. "Shumë shpejt do bëjmë publikë emrat e prefekteve që do shkarkohen dhe atyre që do vijnë në këtë

detyrë. Do kemi një skuadër të re prefektësh që do mbulojnë territorin e tyre në bashkëveprim me Ministrinë e Brendshme. Një skuadër që të punojë fort se i kemi parë prefektët në TV vetëm kur ka pasur përmbajtje", -tha kryeministri Rama. Në një tjetër degjësi nga sistemi i biznesit të shkolës 9 - vjeçare "Jani Minga", kryeministri Edi Rama paralajmëroi largimin e 300 drejtorëve dhe nëndrejtorëve nga sistemi arsimor për shkak të rezultateve tejet të ulëta.

PARALAJMERIMI MINISTRI

Situata e rendit, ministri i Brendshëm paralajmëron shkarkime të tjera në Polici

Krimi, Xhafaj: Ngjarje të rënda, ndryshimet deri në nivele drejtuese

"Analizë e thellë, zbardhja lë për të dëshiruar"

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj paralajmëroi dje shkarkime të reja në Policinë e Shtetit gofhtë në drejtues, gofhtë në rangjet më poshtë duke filluar nga policia e Vlorës, qytet ku ai foli sot. Xhafaj e dha deklaratën nga mbledhja e qeverisë që Rama zhvilloi sot në Vlorë. I pranishëm në mbledhjen në Vlorë, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj vuri në dukje se ekziston një mungesë e efience në policinë e këtij qarku, duke sjellë në vëmendje disa ngjarje kriminale, që mbeten të pazbardhura. Për këtë arsye ai paralajmëroi lëvizje në strukturat e saj. "Është e papranueshme fakti që vetëm gjatë këtij viti janë 5-6 ngjarje të rënda, vrasje me viktima dhe jetë të pafajshme qytetarësh dhe zbulimi i autorëve lë shumë për të dëshiruar, për të mos thënë që për ne është jashtëzakonisht shqetësues. Gjë që do na detyrojë të bëjmë një analizë më të thellë me forcat e policisë dhe duhet të jetë e nevojshme për të bërë edhe ndryshimet edhe përmirësimet e duhura, gofhtë në përbërje të tyre gofhtë në drejtimin e tyre, por është



Ministri i Brendshëm
Fatmir Xhafaj

ANALIZA

"Është e papranueshme fakti që vetëm gjatë këtij viti janë 5-6 ngjarje të rënda, vrasje me viktima dhe jetë të pafajshme qytetarësh dhe zbulimi i autorëve lë shumë për të dëshiruar, për të mos thënë që për ne është jashtëzakonisht shqetësues", - deklaroi z.Xhafaj.

shumë e rëndësishme këtu për të theksuar edhe një komponent të ri", - u shpreh Xhafaj. Ai përmendi se duhet ndërtuar një marrëdhënie e re ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe strukturave të policisë. Policisë dhe

komunitetit. "Këtu është përgjegjësia jonë dhe së bashku me organet e qeverisjes vendore dhe organe të tjera përfaqësuese në territor bëjmë kthesën e duhur, në mënyrë që të kemi mundësi të ndërtojmë një mar-

rëdhënie krejtësisht të re, ndërmjet strukturave të policisë dhe organeve të qeverisjes vendore, ndërmjet policisë dhe qytetarëve", - tha ministri i Brendshëm. Xhafaj foli edhe për situatën e kanabisit dhe suksesit të policisë në këtë qark. "Kjo në funksion të nevojës që kemi për të pasur më shumë efikasitet në parandalimin e krimit, por edhe për një kontroll më të mirë të territorit. Sepse është një fakt i njohur që në disa nga zonat ose në disa nga fshatrat, zonat rurale të Vlorës, gjatë vitit të kaluar ka pasur edhe mbjellje të kanabisit. Ashtu siç është edhe sot një realitet i prekshëm që ky fenomen nuk ekziston më. Pse nuk ekziston më? Edhe në sajë të faktit se kemi një marrëdhënie të re ndërmjet policisë dhe komunitetit", - u shpreh ministri i Brendshëm. Z.Xhafaj u shpreh besimplotë se në radhët e strukturave të policisë të qarkut të Vlorës ka punonjës dhe drejtues policie me shumë integritet, të cilët ai theksoi se do të duhet që të jenë shumë efikas në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Institucioni i Presidencës

Kolegji i Posacëm i Apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, shpall vendet vakante për

7 (SHTATE) KËSHILLTARË LIGJORË DHE 3 (TRE) KËSHILLTARË EKONOMIKË.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkeses nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë", Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 Nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Verifikimi i të dhënave, gjeneralitetet, adresa dhe numri i kontratës kryhen në faqen e OSHEE-së

OSHEE-abonentëve: Përditësoni kontratën ose ju presim dritat

Përditësimi i të dhënave synon identifikimin e klientëve

Ornela Manjani

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike u kërkon abonentëve të përditësojnë të dhënat në kontratën që kanë me operatorin në të kundërt do t'ju ndërpritet energjia elektrike. Kontratë për furnizimin me energji kanë rreth 1.2 milionë dhe një konsiderueshme e tyre nuk kanë të dhëna të sakta. Behet fjalë për gabime në emra, mbiemra, adresa, nuk korrespondon numri i kontratës me emrin e abonentit etj. Për të saktësuar të gjithë të dhënat për çdo abonent OSHEE kërkon përditësimin e kontratës. OSHEE bën të ditur se një pjesë e konsiderueshme e abonentëve kanë kryer përditësimin, por verifikimi për çdo rast kryhet shumë



Foto ilustruese

thjeshtë në faqen zyrtare të OSHEE-së. Lajmi është bërë i ditur nga burime zyrtare pranë OSHEE-së sipas të cilit saktësojnë se u rikujtojnë abonentëve të kryejnë procesin e përditësimit të të dhënave të kontratës së Furnizimit të Energjisë Elektrike, pasi në të kundërt do u ndërpritet energjia elektrike.

PROCEDURA

Procedura për përditësimin e të dhënave kryhet në faqen online të kompanisë është mundësuar aksesimi menjëherëshëm përmes një dritareje të veçantë, që të lejon përditësimin e informacionit. OSHEE bën të ditur se përditësimi i të dhënave synon identifikimin e klientëve e më konkretisht identiteti i plotë i

tyre, adresa e saktë, mënyra si janë të lidhur në rrjet në kuptimin si dhe të dhënat për matësit. Qëllimi i plotësimit të formularit me të dhënat përkatëse, synon saktësimin e të dhënave të klientëve, në mënyrë që të vendoset një marrëdhënie kontraktore e rregullt në shërbim të palëve. Përveç të dhënave të klientit do të evidentohen qartë dhe informacionet mbi objektin që furnizohet me energji elektrike, duke shmangur pasaktësitë e këtyre të dhënave. Procesi pasohet edhe me avantazhe për abonentin, pasi një kontratë me të dhëna të sakta, të plota e të besueshme, e shndërron shërbimin ndaj tij më transparent dhe eficient. Burimet zyrtare nga OSHEE bëjnë të ditur se plotësimi i të dhënave të kërkuara, përfaqëson një detyrim ligjor, referuar ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike".



Përplasja OSHEE-UKT

Dëmtohet katër herë rrjeti i shpërndarjes

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka denoncuar të shtunën, atë çka e ka quajtur "goditjen" e katërt brenda javës nga ana e UKT. Sipas kësaj kompanie, një pjesë e Unazës së Madhe nuk ka energji elektrike për shkak të dëmtimit në rrjet të bërë nga UKT. "Kjo është hera e 4 brenda kësaj jave që abonentë të OSHEE mbeten pa drita për shkak të punimeve të papërgjegjshme nga ana e UKT, pavarësisht apelit tonë për asistencë nga ing. e Operatorit të Shpërndarjes", thuhet në njoftimin e OSHEE. Dëmtimi i fiderit 335 ka lënë pa drita zonën nga Mëzezi deri tek Astiri, ndërsa punimet për riparimin e defektit do të zgjasin. Disa minuta pas publikimit të këtij postimi, OSHEE ka fshirë postimin në "Facebook", duke konstatuar se dëmtimi ka ardhur nga një kompani private dhe jo nga UKT. Defekti i të shtunës, vjen vetëm një ditë pasi, OSHEE njoftoi se kishte riparuar dëmtimin e fiderit nga UKT në zonën pas "Shkollës së Kuqe". Krahas tensionit me ndërmarrjen e ujit, operatori i shpërndarjes duket se ka probleme edhe me punimet e firmave private që ndërhyjnë në llogaritë të Bashkisë. Një vit më parë, OSHEE kallëzoi në polici 11 firma private, të cilat kishin shkaktuar rreth 40 defekte në Tiranë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Njoftim për shprehjen e interesit për vendet vakante të 4 këshilltarëve juridikë dhe 2 këshilltarëve ekonomikë pranë Institutit të Komisionerëve Publikë

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, shpall vendet vakante për 4 (katër) këshilltarë ligjorë dhe 2 (dy) këshilltarë ekonomikë.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data **6 nëntor deri më 10 nëntor 2017**, në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institutit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 12:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë Institutit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatim e lëshuar nga institucioni përkatës postar. Institucioni i Komisionerëve Publikë do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 nëntor deri më 10 nëntor 2017 në adresën info@ikp.al. Institucioni i Komisionerëve Publikë konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim (CV), përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
- Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kriteret e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë), pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) si dhe vetëdeklarim për kriterin e parashikuar nga gërma "e", pika 1 e nenit 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë), pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) si dhe gërma "e", pika 1 e nenit 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Njoftim për shprehjen e interesit për vendin vakant të 1 kancelari pranë Institutit të Komisionerëve Publikë

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr.84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr.94/2017, shpall vendin vakant për 1 (një) kancelar.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data **6 nëntor deri më 10 nëntor 2017**, në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institutit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 12:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë Institutit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatim e lëshuar nga institucioni përkatës postar. Institucioni i Komisionerëve Publikë do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 nëntor deri më 10 nëntor 2017 në adresën info@ikp.al. Institucioni i Komisionerëve Publikë konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

- Jetëshkrim (CV), përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
- Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, dhe vetdeklarim që vërtetojnë kriteret e mëposhtme:
 - je të shtetas shqiptar;
 - ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi ose në shkencë ekonomike me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi ose në shkencë ekonomike jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
 - ka pasur një përvojë pune në nivel menaxherial dhe drejtues, jo më pak se 8 (tetë) vjet;
 - ndaj tij të mos të ketë nisur në nivelin penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me detyrë;
 - të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;
 - ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
 - nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit.
 - nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit "Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" (vetëdeklarim);

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të mësipërme.

Regjistrim fillestar i veçantë i pasurive të paluajtshme, procedurat në 'e-albania'

Regjistrimi i pronës në zonat rurale, kostoja 30 mijë lekë

Tokë me 7501, 9 dokumentet për të marrë tapinë

Ornela Manjani

Regjistrimi i pronave në zonat rurale do të kryhet përmes portalit e-albania dhe ka një kosto prej 30 mijë lekësh. Në të njëjtën portal mund të aplikojnë për certifikatën e pronësisë edhe personat që kanë marrë toke bujqësore me ligjin 7501, por duhet të dërgojnë nëntë dokumente. Shërbimi elektronik për regjistrimin e pronave në zonat rurale u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për regjistrim fillestar të veçantë të pasurive të paluajtshme në zonat rurale për sa kohë zona nuk është përfshirë në këtë proces. Pas dërgimit të aplikimit drejt Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ai do të procesohet nga specialisti i ZRPP-së dhe në varësi të informacionit kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet informimit me e-mail, dërgimit të përgjigjes elektronike të "Dokumentet e mia" në profilin e qytetarit në e-albania, si dhe me shërbim postar nëse qytetari kërkon përgjigjen në format letër. Kërkesa për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), në zbatim të Ligjit Nr. 33/2012 bëhet nga kërkuesi, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, noteri apo asistenti i noteri. Pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme funksionon Regjistri Elektronik i punimit të kërkesave, i cili garanton trajtimin e praktikave sipas radhës së paraqitjes së kërkesave. Minimalisht, në regjistrin regjistrohen numri i kërkesës, data e paraqitjes dhe data e përfundimit të afatit për trajtim, sipas rendit kronologjik. Kërkuesi, që paraqet një kërkesë për kryerjen e një shërbimi nga ZRPP-ja, pajiset me një numër identifikimi të kërkesës dhe Kodin e Sigurisë, me anë të të cilëve mund të verifikojë gjendjen e trajtimit të kërkesës së tij. Kthimi i përgjigjes elektronike dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet dërgimit të "Dokumentet e mia" në e-Albania dhe informimit me e-mail për shkarkimin e përgjigjes elektronike. Gjithashtu, nëse qytetari dëshiron përgjigjen në format letër, e merr nëpërmjet shërbimit postar. Çdo tarifë për shërbimin në ZRPP, paguhet në llogarinë bankare të Zyrës së Regjistrimit.



Foto ilustruese

REGJISTRIMI I TOKËS BUJQËSORE, PRONËS SË FITUAR ME VENDIM ATP

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

1. Dokument identifikimi i përdoruesit: Kartë Identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin e-Albania)
2. Shkresë përcjellëse e institucionit që kërkon regjistrimin e pasurisë
3. Shkresë përcjellëse nga institucioni që ka lëshuar aktin
4. Akt administrativ për vënien e kufizimit
5. Vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve
6. Planvendosje
7. Akt dorëzimi i nënshkruar nga AKP-ja e blerësi
8. Vendim gjyqësor përfundimtar i formës së prerë
9. Planrilevimi

HAPAT E PROCEDURËS

1. Identifikohuni si qytetar ose si biznes në portal
2. Zgjidhni shërbimin "Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ"
3. Klikoni butonin "Përdor"
4. Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, mbi pronën, mbi shërbimin/shërbimet e kërkuara dhe taksat e nevojshme
5. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit
6. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën e nevojshme
7. Punonjësi i ZRPP-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit, me URL-në e shkarkimit të përgjigjes elektronike të ruajtur tek "Dokumentet e mia" në e-Albania, ose me njoftimin e arsyes së refuzimit. Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit 7 ditë pune
- Periudha e vlefshmërisë Pa afat
- Kostot 3500 lekë

Faksimile e pronave në zonat rurale

REGJISTRIMI I PRONAVE NË ZONAT RURALE

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

1. Dokument identifikimi i përdoruesit: Kartë Identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin e-Albania)

HAPAT E PROCEDURËS

1. Identifikohuni si qytetar ose si biznes në portal
2. Zgjidhni shërbimin "Regjistrim fillestar i veçantë i pasurive të paluajtshme në zonat rurale"
3. Klikoni butonin "Përdor"
4. Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, mbi pronën, mbi shërbimin/shërbimet e kërkuara dhe taksat e nevojshme.
5. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit
6. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën e nevojshme
7. Punonjësi i ZRPP-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit, me URL-në e shkarkimit të përgjigjes elektronike të ruajtur tek "Dokumentet e mia" në e-Albania, ose me njoftimin e arsyes së refuzimit
 - Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit 15 ditë pune
 - Periudha e vlefshmërisë Pa afat
 - Kostot 30 000 lekë

REGJISTRIMI I AMTP-së

Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë në bazë të ndonjë ligji, vendim gjykate (vendim komisioni) apo të një akti administrativ (AKKP, AMTP, Bashkia etj.). Pas dërgimit të aplikimit drejt Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), ai do të procesohet nga specialisti i ZRPP-së dhe në varësi të informacionit kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet informimit me e-mail, dërgimit të përgjigjes elektronike të "Dokumentet e mia" në profilin e qytetarit në e-albania, si dhe me shërbim postar, nëse qytetari kërkon përgjigjen në format letër. Kërkesa për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), në zbatim të Ligjit Nr. 33/2012 bëhet nga kërkuesi, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, noteri apo asistenti i noteri. Pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme funksionon Regjistri Elektronik i punimit të kërkesave, i cili garanton trajtimin e praktikave sipas radhës së paraqitjes së kërkesave. Minimalisht, në regjistrin regjistrohen numri i kërkesës, data e paraqitjes dhe data e përfundimit të afatit për trajtim, sipas rendit kronologjik.

KËRKUESI

Kërkuesi, që paraqet një kërkesë për kryerjen e një shërbimi nga ZRPP-ja, pajiset me një numër identifikimi të kërkesës dhe Kodin e Sigurisë, me anë të të cilëve mund të verifikojë gjendjen e trajtimit të kërkesës së tij. Kthimi i përgjigjes elektronike dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet dërgimit të "Dokumentet e mia" në e-albania dhe informimit me e-mail për shkarkimin e përgjigjes elektronike. Gjithashtu, nëse qytetari dëshiron përgjigjen në format letër, e merr nëpërmjet shërbimit postar. Çdo tarifë për shërbimin në ZRPP-ja, paguhet në llogarinë bankare të Zyrës së Regjistrimit.

Dinamika e ngjarjes/ Xhepexhiu u fut poshtë makinës që Xhulio Shkurti e solli nga Italia

Klodiana Lala
Trëndafilë Visha

LUSHNJË

"Zamir Latifi mund t'i shpëtonte masakrës, ja si u vra me 30 plumba nga Laert Haxhiu"

Prokuroria: I riu u plagos në këmbë, por tentoi të vriste me pistoletë atentatorin teksa po hynte brenda në lokal

Zamir Latifi mbase do i kishte shpëtuar masakrës së ndodhur pasditen e 11 tetorit në vendin e quajtur "Ura e Përroit" në qendër të qytetit të Lushnjës nëse nuk do të kishte nxjerrë pistoletën për të qëlluar Laert Haxhiun, i cili po tentonte të hynte në lokalin bar-kafë për të ekzekutuar shënjestrën e tij, Xhulio Shkurtin. Mësohet se 26-vjeçari Latifi ishte i plagosur në këmbë kur ka tentuar t'i kundërpërgjigjet autorit të atentatit me armën që mbante me vete. Por, fati nuk ka qenë me të, pasi Laert Haxhiu menjëherë ka reaguuar, duke derdhur të gjithë plumbat e karikatorit mbi trupin dhe kokën e Latifit. Pak ditë pas ngjarjes së rëndë që tronditi jo vetëm banorët e qytetit të Lushnjës, por mbarë opinionin publik, prokuroria ka rindërtuar gjithë skemën e krimit. Kjo bazuar nga dëshmitë e dhëna nga personat që i mbijetuan atentatit, dëshmitarët okularë si dhe pamjet filmike të bizneseve afër vendit të ngjarjes. Po të njëjtat burime sqaruan me detaje se si i mbijetuan atentatit Marjus Xhepexhiu (djali i pronarit të lokalit) dhe Saimo Xhelili.

DINAMIKA E NGJARJES

Zbardhet e plotë dinamika e ngjarjes së rëndë të ndodhur në qendër të qytetit të Lushnjës, ku mbetën të vrarë dy të rinjtë Jurger Hoxha dhe Zamir Latifi, ndërsa u plagos 26-vjeçari Marjus Xhepexhiu dhe kalimtari i rastit, Bujar Turku, 66 vjeç. Burime zyrtare nga prokuroria pohuan ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare" se pasditen e 11 tetorit, brenda në lokalin që ndodhet pranë vendit të quajtur "Ura e Përroit" ishin duke pirë kafe të rinjtë Marjus Xhepexhiu, Xhulio Shkurti (nipi i Aldo Bares), Saimo Xhelili, Zamir Latifi si dhe një djale me emrin Armando. Sipas këtyre burimeve, mendohet se është bërë një telefonatë në adresë të Laert Haxhiut. Personi që ka telefonuar i ka thënë këtij të fundit që shënjestra e tij ishte me gjithë grupin e tij brenda në lokal. "Shko se i ke të gjithë brenda". Kaq ka mjaftuar që Laert Haxhiu me Orges Bilbilin dhe dy persona të tjerë të nisët drejt lokalit me qëllimin e vetëm për të eliminuar gjithë grupin kundërshtar. Ndërkohë, fati ka ndihmuar Xhulio Shkurtin, pasi 10 minuta para atentatit është telefonuar nga berberi. Shkurti u ka thënë shokëve të tij se i duhej të largohet pasi do të shkonte te berberi. Në atë moment djemtë kanë vendosur të ngrihen dhe kanë dalë jashtë lokalit. Brenda në lokal ka qëndruar vetëm Armando me kamerierin. E ndërsa Xhulio Shkurti është larguar nga lokali, një i njohur ka përshëndetur Saimo Xhelilin. Ky i fundit ka shkuar dhe e ka takuar të njo-



I kërkuari Laert Haxhiu



I kërkuari Orges Bilbili



Viktima Jurger Hoxha



Viktima Zamir Latifi



Xhulio Shkurti

TË MBIJETUARIT

Sapo kanë parë Laert Haxhiun, ata kanë tentuar të largohen. Por, Haxhiu dhe dy të tjerët kanë qëlluar në drejtim të tyre me breshëri kallashnikovi. Saimo Xhelili, duke qenë se ishte më larg, ka mundur të largohet dhe t'i shpëtojë masakrës. Ndërsa, Marjus Xhepexhiu është futur poshtë makinës me targa italiane të Xhulio Shkurtit, e cila ndodhej e parkuar para lokalit. Mësohet se mjeti ishte sjellë nga Italia nga Xhulio Shkurti 72 orë para ngjarjes.

TELEFONATA

Pasditen e 11 tetorit, brenda në lokalin që ndodhet pranë vendit të quajtur "Ura e Përroit" ishin duke pirë kafe të rinjtë Marjus Xhepexhiu, Xhulio Shkurti (nipi i Aldo Bares), Saimo Xhelili, Zamir Latifi si dhe një djale me emrin Armando. Sipas këtyre burimeve, mendohet se është bërë një telefonatë në adresë të Laert Haxhiut. Personi që ka telefonuar i ka thënë këtij të fundit që shënjestra e tij ishte me gjithë grupin e tij brenda në lokal. "Shko se i ke të gjithë brenda".

Biznesmeni Julian Sula u shoqërua dhe u mor në pyetje

Atentati me 2 të vrarë e 2 të plagosur në Lushnjë, lihet i lirë "Juli i Pashakos"



Vendi ku ndodhi ngjarja

LUSHNJË - Biznesmeni Julian Sula, për të cilin dy ditë më parë u përfol se dyshohej të ishte atentatori i tretë i masakrës së Lushnjës që ndodhi pasditen e 11 tetorit, nuk është vetëdorëzuar në polici. Mësohet se Sula, banues në lagjen "Karbunara", është shoqëruar dhe marrë në pyetje paraditen e së premtes nga policia për të dhënë deklaratime për ngjarjen, si person që kish të njohje me Laert Haxhiun dhe Orges Bilbilin, dy nga atentatorët e dyshuar. Burime nga grupi hetimor thanë se Julian Sula është pyetur në lidhje me vendndodhjen e tij pasditen e së mërkurës dhe nëse ka pasur komunikim me miqtë e tij, Orges Bilbili e Laert Hoxha. Por, hetuesit nuk kanë gjetur fakte dhe prova që

hurin e tij, i cili ndodhej afro 12 metra larg lokalit. Ndërkaj, para lokalit kanë qenë në këmbë Zamir Latifi, Marjus Xhepexhiu dhe Jurger Hoxha. Këta të fundit kanë pikasur makinën tip "Benz",

e lidhin me atentatin e të mërkurës. Burimet e mësipërme bënë dije se pas marrjes në pyetje,

nga e cila kanë zbritur tre persona (një tjetër ka qëndruar brenda), por ka qenë shumë vonë. Sapo kanë parë Laert Haxhiun, ata kanë tentuar të largohen. Por Haxhiu dhe dy të tjerët kanë qëllu-

ar në drejtim të tyre me breshëri kallashnikovi. Saimo Xhelili, duke qenë se ishte më larg, ka mundur të largohet dhe t'i shpëtojë masakrës. Ndërsa, Marjus Xhepexhiu është futur posh-

të i njohur nga policia lokale për shkak të precedentëve penalë që lidhen me plagosje të rënda me thikë dhe armë zjarri. Sakaq mësohet se pak orë pas krimit që tronditi Lushnjën, policia ka ushtruar kontroll në 20 banesa, ku një prej të cilave ishte dhe ajo e Sulës. Aktualisht, në Komisarariatit e Lushnjës nuk ka asnjë person të ndaluar për këtë ngjarje, ndërsa në kërkim janë shtallur Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili. Lidhur me këtë ngjarje janë pyetur shumë persona, që janë kontingjent për policinë.

të makinës me targa italiane të Xhulio Shkurtit, e cila ndodhej e parkuar para lokalit. Mësohet se mjeti ishte sjellë nga Italia nga Xhulio Shkurti 72 orë para ngjarjes. Nga të shtënat e para ka mbetur i plagosur në këmbë Zamir Latifi. Ndërkaj, Laert Haxhiu ka tentuar të futet me kallash në lokal, pasi mendonte se shënjestra e tij Xhulio Shkurti ndodhej brenda. Në këtë moment, 26-vjeçari Zamir Latifi ka nxjerrë pistoletën dhe ka tentuar të qëllojë drejt Haxhiut. Por, kundërshtari i tij është kthyer menjëherë dhe i ka zbrazur në trup dhe në kokë 30 plumba Latifit, duke e bërë shoshë dhe duke e lënë të vdekur në vend. Laerti ka provuar të qëllojë sërish, por nuk kishte më plumba, ndaj u ka thënë shokëve të tij që të largoheshin me makinë. Atentatorët janë larguar me shpejtësi në drejtim të vendit të quajtur "Plasmasi" për të mos u kapur dot nga policia, e cila mbërriti shpejt në vendngjarje. Tri makina të bluve kanë rrethuar vendin e ngjarjes, ndërsa autorëve të masakrës nuk u ka hyrë gjem në këmbë. Dy ditë më parë, xhaxhai i viktimës Jurger Hoxha deklaroi për "GSH", se policia nuk i ndoqi, por i la të iknin vrasësit.



INVITATION TO TENDER

REHABILITATION of Health Center in Fier

The Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate the Health Center in Patos, in the Municipality of Fier. In the context of this initiative, HAP Centre is requesting offers from companies interested in carry out those rehabilitation works. The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link

<https://drive.google.com/drive/folders/0B4R3lo0APolbSVNURJF5aGZldUU>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by **sending an email to info@hap.org.al until 16th October 2017.**

The interested Companies must participate in the site visit to take place within **October 2017**. The details of **place and time of the visit will be given to the interested Companies on the 17th October 2017.**

The bidding Companies should submit their offers to **HAP Centre no later than end of business day on the 10th November 2017.**

The offer should include:

1. Letter of interest;
2. The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Annex 2);
3. The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Annex 2);
4. CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
5. CVs of directors of the Company;
6. CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Annex 4.2 and Annex 4.3);
7. The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Annex 4, Annex 4.1.1 and Annex 4.1.2);
8. Copy of the registration and license of the company;
9. Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
10. Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works);
11. For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope **no later than end of business day on the 10th November 2017** to the address:

Subject: **REHABILITATION OF HEALTH CENTRE OF PATOS IN FIER REGION**

Procurement Team

HAP Centre

Rruga "Themistokli Gërmenji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania

E-mail: info@hap.org.al; Website: www.hap.org.al



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



INVITATION TO TENDER

REHABILITATION OF Health Center in Roskovec

The Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate 3 Health Centers in Kurjan, Strum and Roskovec in the Municipality of Roskovec, in Fier Region. In the context of this initiative HAP Centre is requesting offers from companies interested in carry out those rehabilitation works.

The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link

<https://drive.google.com/open?id=0B4R3lo0APolbEc2T0tuS1RqVm8>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by **sending an email to info@hap.org.al until 16th October 2017.**

The interested Companies must participate in the site visit to take place within **October 2017**. The details of **place and time of the visit will be given to the interested Companies on the 17th October 2017.**

The bidding Companies should submit their offers to **HAP Centre no later than end of business day on the 10th November 2017.**

The offer should include:

1. Letter of interest;
2. The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Annex 2);
3. The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Annex 2);
4. CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
5. CVs of directors of the Company;
6. CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Annex 4.2 and Annex 4.3);
7. The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Annex 4, Annex 4.1.1 and Annex 4.1.2);
8. Copy of the registration and license of the company;
9. Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
10. Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works);
11. For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope **no later than end of business day on the 10th November 2017** to the address:

Subject: **REHABILITATION OF HEALTH CENTRE OF KURJAN, STRUME, ROSKOVEC IN FIER REGION**

Procurement Team

HAP Centre

Rruga "Themistokli Gërmenji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania

E-mail: info@hap.org.al; Website: www.hap.org.al



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Call for: Engineering Company to provide supervisory works for the rehabilitation of four Health Centres in Fier region

Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by Health for All Centre in Fier and Diber Regions. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

To improve conditions for health workers and users in four Health Centres in Fier, HAP Centre will contract an engineering company, here in called **The Contractor**, to do the rehabilitation in those Centres. To supervise the **Contractor's** works, HAP Centre will contract an engineer Company, here in called **The Provider**, to supervise the rehabilitation works as described in the TOR in the below link:

<https://drive.google.com/file/d/0B4R3lo0APolbNGIQRmVfN0t6Tms/view>

The offer should include:

1. A financial offer specifying only the supervisor-day fee and transportation cost;
2. CV of the bidder, CV of the Directors of the Company and its technical team, with details of their field of engineering, and detailed description of previous works similar to the ones expected under this TOR;
3. Names of three references of similar works, from which HAP can get information on the qualification of the bidder;
4. Licenses and registrations proving that the bidder is duly accredited and certified for carrying out the works described in the TOR

Those submitting an application should be aware that, if selected and contracted, they will be required to issue invoices (VAT or A4).

Deadline for application

The offers must be delivered by **25 October 2017** in sealed envelopes and with clearly marked "Public Invitation to Tender for Engineering Company" to;

Procurement Team

HAP Centre

Rruga "Themistokli Gërmenji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania

E-mail: info@hap.org.al; www.hap.org.al

*Please note that the shortlisted applications will be contacted within 08 November 2017.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

BalkanWebJ.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KËRKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Më 6 qershor të 2016-ës, plagosi Bledar Muçën dhe një punonjëse policie

Atentati ndaj Çapjas, ekstradohet nga Holanda i dyshuari si vrasës me pagesë

Shkëlzen Hasanpapaj u zbulua nga analiza e ADN-së

ELBASAN

Shkëlzen Hasanpapaj, i cili u përfshi në atentatin e ndodhur në qershor të vitit 2016 ndaj Florenc Çapjas dhe Bledar Muçës në Elbasan, është ekstraduar nga Holanda. Mësohet se 19-vjeçari i dyshuar si vrasës me pagesë, pak kohë më parë, nën masa të rrepta sigurie dhe pa u bërë publik është sjellë në Shqipëri. Hasanpapaj u prangos në shkurt të vitit 2017 nga policia holandeze, pasi u pikas atje pa dokumente, ndërsa rezultoi se ndaj tij kishte një urdhër arresti ndërkombëtar. Ndërkohë që analiza e ADN-së që konfirmoi përfshirjen e tij në ngjarjen e ndodhur vitin e kaluar. Kjo gjurmë ADN-je u përfutua nga rrobat që ai braktisi pak çaste pasi kreu atentatin në oborrin e gjykatës së Elbasanit, ku që-



Shkëlzen Hasanpapaj i ekstraduar nga Holanda

loi ndaj Florenc Çapjas dhe Bledar Muçës (mbeti i plagosur) e po ashtu plagosi dhe një punonjëse policie. Burime nga grupi hetimor sqaruan se me mbërritjen në Shqipëri Hasanpapaj i është bërë edhe një herë analiza e ADN-së, e cila po ashtu ka konfirmuar gjurmët krahasues të profilit gjenetik të gjetura në rrobat e tij. Aktualisht 19-vjeçari Shkëlzen Hasanpapaj ndodhet në paraburgim, pranë një burgu të sigurisë së lartë në vend, dhe ruhet përjetë 24 orëve. Ai konsiderohet si një person kyç për hetuesit për zbardhjen e atentatit ndaj

ARRESTIMI

Shkëlzen Hasanpapaj, banues në Elbasan, u arrestua nga policia e këtij qyteti afro dy javë pas atentatit ndaj Florenc Çapjas dhe Bledar Muçës. Ai u prangos më 22 qershor të vitit 2016, pasi në lagjen "Viseiron Xhuvani" u kap duke drejtuar pa leje drejtimin motorin tip "Yamaha". Adoleshenti u la i lirë nga Gjykata dhe pas këtij momenti u largua nga Shqipëria në drejtim të Italisë, i ndihmuar nga tre persona të tjerë. Më pas ai ka shkuar në Holandë.

Florenc Çapjas dhe Bledar Muçës, të ndodhur më 6 qershor të 2016-ës. Hasanpapaj është sjellë në Rinas nga policia holandeze dhe me autoblindë është dërguar në qeli, ku prej më shumë se 3 javësh nuk ka pranuar të flasë për hetuesit në lidhje me atentatin.



42-vjeçari Durim Keçi

Gjykata jep "Arrest me burg" për të "fortin" e Shijakut, Durim Keçi

DURRËS - Gjykata e Shkallës së Parë e Durrësit dje vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" me qëllim ekstradimin drejt Italisë të 42-vjeçarit Durim Keçi, i cili u arrestua të mërkurën nga policia. I "forti" nga Shijaku u kap, pasi rezultoi në kërkim nga autoritetet italiane për trafik droge, pjesëmarrje në organizatë kriminale dhe shfrytëzimin prostitucioni. Seanca gjyqësore ndaj Keçit u zhvillua nën masa të rrepta sigurie. Gjykata ishte "blinduar" që në mëngjes nga forcat e policisë, të cilët nuk lanë të hynte asnjë familjar në sallën e gjyqit. Gjatë fjalës së tij, prokurori i çështjes, Ilir Turja kërkoi nga gjykata lënien në burg për 42-vjeçarin me pretendimin se, nisur nga dënimi i marrë në Itali (Gjykata e Gjenovës e ka dënuar me 9.7 vjet burg), ai paraqet rrezikshmëri. Ndërkaq, avokati mbrojtës Ilia Ilia i kujtoi gjykatës Elda Kaja operacionin e policisë italiane të koduar "Kanun", në zonën e Bergamos në Itali, ku brenda një nate u arrestuan 135 banorë të Shijakut. Sipas tij, u montua një gjyq manipulor dhe diskriminues ndaj shqiptarëve asokohe. "Është proces me natyrë raciste, për shkak të diskriminimit të të qenit shqiptarë. Procesi ka pasur për objekt procedimin 135 shqiptarë nga zona e Shijakut. Në kushtet që kemi vetëm një urdhër pa firmë, pa vull, nuk plotëson kriteret për të realizuar arrestin në flagrancë", - tha avokati Ilia Ilia. Ndërkaq, ai i kërkoi gjykatës të lërë të lirë klientin e tij, që sipas tij nuk është arratisur nga Italia, por vetëm është larguar dhe nuk paraqet asnjë rrezikshmëri. Gjykatësja Elda Kaja vendosi ta konsiderojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë, ndërsa dha masën e sigurisë "Arrest me burg" të përkohshëm me qëllim ekstradimin drejt vendit fqinj, ku Durim Keçi është i dënuar me vendim të formës së prerë. **kl.ha.**

BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta vipave

Vipave

çdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

GREQI

I prenë kokën për borxhin 20 mijë euro, dënohen me burg përjetë vrasësit e Bledar Terpollarit

Përfundon në Gjykatën e Korfuzit gjyqi për vrasjen me prerje koke të Bledar Terpollarit nga Backa e Skraparit më 9 maj të vitit 2016 në Gliku të Igumenicës. Gjykata dënoi me burgim të përjetshëm (me të drejtë lirie pas 20 vitesh) plus 5 vjet të tjera burg shtetasit Emiljano Nana, 28 vjeç, nga fshati Tosk Martaloz i Tepelenës, dhe Vidjon Gogaj, 27 vjeç, nga Fieri. Ndërsa është shpallur i pafajshëm Pajtim Jaupi, 28 vjeç, nga Tepelena. Në kërkim mësohet se është Krenar Terpollari, 27 vjeç, i cili ndodhet i arrestuar në Shqipëri, dhe një shtetas tjetër shqiptar. Në vendimin e gjykatës thuhet që vrasja ndodhi për shkak të prishjes së pazareve të drogës. Viktima u kishte borxh vrasësve 20 mijë euro të fituara nga shitja e drogës në Greqi.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e suportit një vjeçar të produkteve Checkpoint"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,800,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e suportit një vjeçar të produkteve Checkpoint"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 8 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BOTIMI

Prestigjiozja "Vogue" përshkruan ish-Blokun: Një vorbull pulsuese dhe argëtuese

"Vogue" reportazh për Tiranën:

Ish-fortesa e komunizmit, tashmë një destinacion gjallërues

Një nga revistat më prestigjioze në botë në fushën e jetës dhe modës, "Vogue", i ka diktuar një reportazh të gjerë në seksionin e saj për udhëtimet, transformimin total të kryeqytetit shqiptar, Tiranës. Në këtë artikull theksohet fakti që Tirana, një ish-zyrtet i mbyllur komunist, tashmë është një qytet krejtësisht i gjallëruar dhe me banorë shumë miqësorë, i cili përbën një atraksion të parë shumë të mirë edhe për ata që dëshirojnë të vizitojnë bregdetin e Adriatikut dhe monumentet arkeologjike. Artikulli i botuar nga "Vogue" evidenton që në fillim transformimin e madh që ka pësuar Tirana, nga kryeqyteti i vendit më të izoluar në botë, në një kryeqytet të gjallë dhe plot jetë. "Vibrimi këtu, pozitiv dhe i shkuadësor, është i prekshëm dhe bën jehonë në restorante, bare dhe kafene në të gjitha lagjet dhe në të gjithë Tiranën. E çuditshme, kjo ish-fortesë e komunizmit është e gjallë dhe e përballeshme, banorët e saj janë të hapur dhe miqësorë. Interesi në vendet e Ballkanit është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, me udhëtarët kuriozë që kërkojnë rregullisht qetësinë e detit Adriatik dhe qytetet mesjetare me mure prej guri, si Dubrovniku në Kroaci dhe Kotorri në Mal të Zi. Tirana nuk mishiheron një tërheqje të tillë tradicionale, piktoreske. Në vend të kësaj, ajo impresionon si një qendër shpirtërore, urbane, me një personalitet të fortë të formuar nga një histori e trazuar. Ashtu si Sarajeva që u zhvendos shumë larg miqësorëve të viteve 1990 duke evoluuar në një kryeqytet të begatë të Europës Lindore, Shqipëria po lë pas dekadat e veta të tmerrit dhe izolimit e saj në të ardhmen", thuhet në këtë reportazh. Autori në reportazhin e vet ndalet edhe në zonën-simbol të udhëheqjes së komunizmit, e cila sot është kthyer në qendrën e jetës së natës në Tiranë dhe në vendin më të preferuar nga të rinjtë. "Radioja' gjendet në

"Mësuesi i kthyer në diktator, Enver Hoxha ndërtoi 750.000 bunkerë"

një lagje të quajtur ish-Bloku, i njohur gjithashtu si Bloku. Sot Bloku është një vorbull pulsuese dhe argëtuese, me terraca të panumërta të jashtme, që përputhen me së miri me mysafirët e veshur mirë. Ajo ka një atmosferë shumë të zjarrtë dhe të relaksuar, e cila të kujton Athinën dhe Palermon. Megjithatë, gjatë viteve komuniste, Bloku ishte jashtë kufijve të cilitdo që nuk ishte anëtar i elitës së partise", shkruan autori. Më tej, në këtë artikull jepet dhe një përshkrim i asaj që përfaqëson Shqipëria dhe Tirana para '90-ës dhe gjithë të këqijat që i solli regjimi diktatoriali vendit. "Deri në rënien

burgosi, torturoi dhe vrau rreth 100.000 qytetarë shqiptarë në këtë proces. Totalisht paranojak, ai urdhëroi ndërtime dhe shumë se 750.000 bunkerë, me qëllim për të zbutur frikën e tij kronike të pushtimit të jashtëm", shkruan "Vogue". Në fakt, paranoja e ish-regjimit komunist dhe fortifikimi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë është, sipas "Vogue", një element shumë i rëndësishëm për të kuptuar dhe ndryshimin radikal të Tiranës moderne dhe vibrante që sot është. Autori veçon në reportazhin e tij disa nga pikat më atraktive dhe interesante të Tiranës, që mbartin dhe kureshtjen për t'u vizituar. "Përshkrimi në



e komunizmit në 1991-shin, rajoni nuk ishte i huaj për socializmin. Por sforcimi i Shqipërisë, nën udhëheqjen e diktatorit stalinist-maoist, mësues i kthyer në diktator Enver Hoxha, ishte veçanërisht i përgendruar dhe shtypës. Hoxha mbizotëroi mbi Shqipërinë për më shumë se 40 vjet deri në vdekjen e tij në vitin 1985, dhe ai me sa duket

këtë të kaluar të shtrembëruar, është thelbësore për të kuptuar Tiranën e sotme, dhe një pikënisje kryesore është Muzeu Historik Kombëtar në sheshin 'Skënderbej', një vend i organizuar kronologjikisht me objektet arkeologjike. Edhe më i mahnitshëm është 'Bunk'Art', një prej atyre bunkerëve të fshehtë të luftës bërthamore në skajet e kodrës së



Tiranës që është shndërruar në një muze. Këtu, në një labirint galerish, endesh nëpër zyrën e ruajtur të Hoxhës dhe shikon një video hipnotike të varrimit të tij. Në qendër të qytetit është 'Bunk'Art 2', një përkujtim për viktimat e regjimit të Hoxhës, i mbushur me fotografi dhe dokumente me domethënëse. Është efektivisht i pozicionuar pranë Shtëpisë së Gjetheve. Dikur shtabi i policisë sekrete të Sigurimit të Hoxhës, muzeu i imët ndriçon taktikat interesante të mbikëqyrjes së asaj epoke. I armatosur me njohuri për trashëgiminë e Shqipërisë, një njeri i mbushur me vdekje, tirani dhe spionazh, ndoshta bëhet më e qartë se përse Tirana është aq bashkëkohore, njerëzit e saj janë kaq të gëzuar: më në fund jetojnë një jetë të lirë dhe me kreativitet, frymëzuar dhe nxitur edhe nga kombet që u ishte ndaluar të ndërvepronin me dekada të tëra. Tirana nuk është ende një parajsë turistike, pavarësisht hijeshisë së saj, por pshuesit po shohin potencialin për të kaluar kohën këtu", thuhet në artikull. Një tjetër element që e bën Tiranën sipas "Vogue" interesante është edhe gastronomia. "Ushqimi dhe pijet janë elemente jetësore, shogërore të kulturës së Tiranës. Ushqimi më i shëndetshëm po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për banorët e Tiranës rinore. Në afërsi të

Piramidës së Tiranës, një monument komunist i shkatërruar, ata porosisin gota me verë në restorantet përreth", evidenton autori në përpjekjen e tij për të zbuluar Tiranën. Gjithashtu, në këtë reportazh një tjetër element që ka rënë në sy të autorit është edhe popullsia e re dhe roli që luajnë në jetën e qytetit eksperimentar e suksesshëm që vijnë nga shqiptarët që kanë jetuar jashtë vendit, duke i transmetuar kështu shoqërisë të gjitha eksperiencat e tyre të emigrimit. Kjo cilësohet si një faktor i rëndësishëm për rigjallërimin e qytetit, duke e kthyer atë në një qytet kozmopolit, të denjë për statusin e tij, atraktiv për t'u vizituar. "Popullsia e qytetit është trefishuar në njëzet vjet, duke përfshirë shqiptarë të cilët dikur emigruan dhe tani u kthyen me njohuri të shkëlqyera të bareve, restoranteve dhe jetës së natës. Kuzhinierët më të mirë dhe baristët erdhën nga qytetet e mëdha evropiane, ku mësuan afijshësitë e tyre, të cilat po i ushtrojnë dhe ua kalojnë me sukses të tjerëve. Së bashku me plazhet e Rivierës shqiptare dhe pamjet e mrekullueshme natyrore në pjesën jugperëndimore të vendit në detin Jon, Tirana e zhurmshme është një fillim i këndshëm, kozmopolit, për një aventurë bregdetare në Ballkan", thuhet në këtë reportazh të botuar nga prestigjiozja "Vogue".

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillohet ankimand për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Aparatament", me Nr. Pasurie 5330-1-3, Zona Kadasrale 0513, Vll.14, Fq.49, me sipërfaqe 52.02 m², le inoður ne P/Sonar/17, Pll.19/781, Sk.1, Ag.8, Durrës, për shpënjeh e detyrimet ne favor te kreditorit ProCredit Banki Sh.a., për shumën 1947780.58 (nëq milion e nontëqind e dyzetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) Lekë dhe 33.6 (tridhjetë e tre pike gjashtë)Euro.
Cmimi filltar me të cilin fillon ankand është ne shumën 22'400 (njëzetë e dy mijë e katërqind) Euro.

Ankand zhvillohet ne date 25.10.2017, ora 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Toptani, Cendra Torre Drin, K1.2, Nr.33, Tirane, dhe por informacion mund te kontaktoni ne Nr.0682099471, 0684054605, email ermirdgodaj@zyrapermbarimit.com.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 16.10.2017 ne oren 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Irlisa Tereziu PF me adresë ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjella, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankand per shitjen e pasurisë së paluajtshme te lloji Ape+Truall+Shitepi+Banimi me sipërfaqe totale 2000 m² nga e cila truall 500 m² nga kjo ndërtesë 3 kateshe me sipërfaqe totale 544 m², e regjistruar ne regjistrin hipotekor me volum 4, faqe 3, numer pasurie 34/44, ne zonen kadastrale 1934, me adrese Hasan (Kruje).Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren 6.552.000 (gjashte milion e peseqind e pesedhjetë e dy mijë) lekë.

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON"
me PËRMBARUESI GJYQËSORE SUELA METHOXHA

Dt 13.10.2017 ora 16:00 '
Përfundon Ankand i Parë për pasuritë:

- Pasuria "Aparatament" me sip. 27 m2, Nr. pasurie 7/834-1-3, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 166 me adresë L. Nr. 5 Kavajë
Me çmim 7 840 EURO
- Pasuria "Aparatament" me sip. 40 m2, Nr. pasurie 7/834-1-3/1, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 167 me adresë L. Nr. 5 Kavajë
Me çmim 11 600 EURO
- Pasuria "Aparatament" me sip. 66 m2, Nr. pasurie 7/834-1-4, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 168 me adresë L. Nr. 5 Kavajë
Me çmim 18 960 EURO

Ankand zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

TRASHEGIMIA

Kumbaro: Pse e ndalova ndërtimin në Butrint

Në një intervistë për gazetaren Nisida Tufa në "Kjo javë" në "News24", ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro ka sqaruar edhe një herë atë që njihet si skandali në parkun e Butrintit. Prej ditësh, ndërtimi, ose siç thotë Kumbaro rehabilitimi i një godine në Parkun Kombëtar ka qenë në vëmendje të opinionit publik, pasi ligji nje pengesa të shumta për ndërtime e ndërhyrje brenda një zone arkeologjike. Edhe në këtë intervistë, Kumbaro tha se nuk është ndërtim por rehabilitim i godinës për ta kthyer në pikë shërbimi, dhe se është respektuar ligji i trashëgimisë, VKM-të dhe udhëzimet për zonat e mbrojtura dhe dhënien me qira.

"ZHURMA" ME 40 TONË BETON

E pyetur nga Tufa se "si e keni parë këtë zhurmë", Kumbaro tha se "lidhur me zhurmën, e shoh edhe si vëmendje ndaj kulturës" dhe se shqetësimi i saj shkaktohet edhe në këtë rast për shkak të dezinformimit. "Nuk po hyj të bëj analiza nëse dezinformuesit janë keqdashës po ka edhe keqdashje. Ndonjëherë vjen nga padija dhe paqartësia, ndonjëherë është qëllimi negativ për të deformuar". Kumbaro mohoi zërat që ka ndryshim të projektit fillestar. Kujtoi edhe një herë se godina është ndërtuar më 1975-ën dhe se ka fluks turistësh që kërkojnë shërbim. "Nuk i shtohet asnjë centimetër volumnit godinës, e cila do të rehabilitohet. Muret të rregullohen, do të pastrohen, ndërsa jashtë godinës, përpara do të shtrohet një platformë", - tha ministrja. E pyetur nga gazetaria nëse platforma është prej betoni, Kumbaro tha se platforma është druri, jo betoni. "Objekti ekzistues dhe platforma e re shkojnë 100 m². Nuk ka shtesë volumni, nuk hapen themele. Megjithatë për tulla, po sqaroj se tullat janë për rehabilitimin e mureve të brendshme".

Ajo pranoi se në godinë punohet prej muajit gusht dhe se betoni i përdorur, është për pjesën e platformës përpara, "për të mbajtur strukturat e verandës me elementë druri e xhami, ka sipërfaqe të ngushtë hekurit, me beton të varfëruar brenda të gjithë parametrave që parashikohen në trashëgimi". E pyetur nëse aty hidhen 40 tonë beton, sikundër njëri prej deputetëve tha të mërkurën në Komisionin Parlamentar gjatë dëgjësës së Kumbaros për Butrintin, ministrja tha se "përgjigjia

është në projektin e miratuar nga KKA dhe KKR. Karta e restaurimit thuhet se nuk lejohen gërmime nën 40 cm por lejohen rehabilitime e restaurime me elemente reversibile (të lëvizshme)".

FUNKSIONI I OBJEKTIT

A do të jetë objekti restorant? Ministrja mohon. Megjithatë shtoi se kjo pikë shërbimi, është pjesë e një filozofie më të gjerë, pasi ka shtim të numrit të turistëve. "Kemi marrëveshje me përfaqësuesit e komunitetit të artizanatit që të kenë ambiente me dru për të shitur dhe jo si shitet tani me tenxhere të mbuluara me letër. Aty nuk bëhet fjalë për restorant. Është abuzim edhe pjesa e salsiçeve", - tha Kumbaro e pyetur nëse do ketë tym.

Sipas saj, kompania e përzgjedhur për të investuar është në gjendje të ofrojë disa shërbime. Ajo tha se "do të ketë ushqime të lehta të paketuara dhe pije të freskëta. Në katër vite, nuk gjeni asnjë vend ku trashëgimia ka elementë të degraduar. Kjo është garancia jonë", - tha ministrja.

PROJEKTET

Sipas saj, ka disa VKM që i japin të drejtë ministrit të Kulturës të lejojë dhënien me qira në 200 metra hapësirë nga monumentet. "Nga pikëpamja ligjore nuk është hera e parë që ndodh, por modelet janë kërkuar të ndryshme. Për këtë sit janë rre-

"Jam gati të përballem me prokurorinë, tullat janë për rehabilitimin e mureve të brendshme"



Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro

zuar 5-6 projekte. Një prej tyre edhe ky i kompanisë së përzgjedhur. Në vitin 2015, hartuar një udhëzim për mënyrën se si mund të jepet me qira shtet trashëgimisë kulturore. Në udhëzim detajohet në mënyrë shumë të qartë se si mund të jepet me qira, parashikohet edhe ngritja e një komisioni vlerësimi. Edhe për këtë projekt, të hartuar nga vetë IMK-ja që të respektoheshin rregullat, janë shprehur organet e specializuara apo drejtoritë rajonale në terren", - tha ministrja. Sipas Kum-

baros, pas rrëzimit të kërkesës së vitit 2016, nga e njëjta kompani për investimin në fjalë, në janar të këtij viti, subjekti erdhi sërish me kërkesë. "Ka një kontratë që përcakton, orare e tipologji shitjesh të kufizuara. Për shembull, nuk lejohet alkooli, dhe nuk është pas orës 8. Kërkesa erdhi në janar, është vlerësuar në muajt janar, shkurt, mars, dhe ka një urdhrë ministri që ngre komisionin më pas. Ne thamë, 'që të jemi të garantuar, e bëjmë vetë projektin'.

Kontrata me subjektin, përkundër baltës, është korrekte".

E pyetur nëse ka konflikt interesi, ajo tha sërish: "Të më provohet konflikti i interesit. Të çohen denoncimet në prokurori, jam gati të përballem. Kompania është e njohur në treg. Ka të drejtë të vjë si shumë operatorë të tjerë".

PUNIMET NDALEN

E pyetur për punimet, ajo tha se kanë filluar në gusht, janë caktuar supervizori dhe kolaudatori që ndjekin rregullisht çdo gjë që ndodh në Butrint, ndërsa adminis-

Ajo tha se do të ketë ushqime të lehta të paketuara dhe pije të freskëta.

trata e parkut ka arkeologë të sajët. Kumbaro tha se vetë informohet çdo ditë për çfarë ndodh. Ndërkaq, bëri me dije se "për shkak të sensibilitetit që krijoi në opinionin publik, kam ndaluar punimet. Është më e rëndësishme të shterohen pyetjet. Kam kërkuar të ndalen punimet. E kam kërkuar të ndalohen punimet me një shkresë, me bindjen që vlen të shterohen të gjitha pyetjet pastaj të vijojë. Këtë e kam bërë për rëndësinë që i jap opinionit publik. Aty janë ndaluar punimet ditën e martë ose të mërkurë, ndërkohë punëtorët po mbulojnë sitin për ta garantuar nga agjentët atmosferikë".

Kumbaro shtoi, se fton këdo ta shohë sitin dhe godinën. "Nuk kam asnjë ngut e asnjë shqetësim, sepse kemi zbatuar ligjin e procedurat një më një. Jam optimiste, se kam zbatuar ligjin dhe kam pasuruar ligjin me elementë që sigurojnë dhe mbrojnë trashëgiminë. Ka shumë që bëjnë zhurmë në emër të trashëgimisë kulturore sepse, e dini çfarë, mund t'u jenë prekur disa interese", - tha ajo në fund të intervistës me Nisida Tufën.

NJË EKSPOZITË E ZAKONSHME E FOTOGRAFES QË E NDALUAN TË HYNTE NË SHQIPËRI NË KOMUNIZËM

Ishte pesë vjeçe kur familja e fotografes franceze vendosi të bënte një tur në Ballkan. "Prindërit e mi kishin vendosur të udhëtonin nëpër vendet e Ballkanit dhe shkuan në Greqi përmes Jugosllavisë. Gjatë këtij udhëtimi ata mësuan se të shkoje në Shqipëri ishte e ndaluar. Ishte një vend i izoluar. Kjo ndalesë më mbeti gjatë në kujtesë, si një fabul që më ngacmonte që nga fëmijëria. Babai kishte bërë shumë fotografi nga ky udhëtim dhe nuk më është hequr kurrë nga mendja ndalimi i aventurës sonë në portat e një vendi që më ishte varrosur në kujtesë dhe që u shfaq përsëri vite më vonë, që ishte Shqipëria", - thotë Virgin-

ie Caquot, që ka çelur dje në GKA ekspozitën "Në Vendin e Shqiponjave" me 30 fotografi bardhezi. Atëkohë, ata patën mbërritur deri në Mal të Zi, para portave të mbyllura shqiptare, ku rruga e tyre ndalei.

Prej dy vitesh ajo është vendosur në Shqipëri për të eksploruar vendin. Në fund, ajo sjell disa fotografi kërkuar të zakonshme, pazareshe, sheshesh, bregdeti e bregliqeni, peshkatarësh e fëmijësh, a tufa të imtash a lopësh, që ndodh të dalin para makinës në zonat rurale. Të para me sytë e një francezeje si ajo, këto imazhe "janë rezultat i këtyre emocioneve që kam ndjerë gjatë këtyre dy viteve

duke udhëtuar nëpër Shqipëri, dhe shpresoj shumë që emocionet e mia të jenë përcjellë në këtë ekspozitë". Përndryshe është Shqipëria e përditshme në skenë të përditshme, në fotografi të zakonshme. Vetë fotografja e pranoi se janë imazhe të çastit, të pamenduar më parë. "Asnjëra nga fotografitë nuk është e programuar. Nuk kam kompozuar më herët asnjë foto, por kam kapur çastin që rrefën traditën e përpjekjen për t'u modernizuar në të njëjtën kohë. Fotografitë janë zgjedhur bardhezi, pasi më duket se kështu theksohet edhe më shumë përpjekja shqiptare për të lëvizur shpejt drejt një bote më moderne, pa

harruar asnjëherë traditën". Megjithatë, ajo tha para mediave se "çdo foto është e rrallë dhe bart një histori, sepse është një cast i Shqipërisë aktuale. Doja që në këto fotografi të transmetoja një pjesë tradicionale të Shqipërisë dhe vendosur përballë modernitetit ku të dyja përzihen. Kjo është Shqipëria e sotme". E njëjta fotografe e ka çelur ekspozitën edhe në COD me të njëjtin titull.

Ekspozita fotografike e Virginie Caquot do të qëndrojë e hapur deri më 23 tetor 2017. Fotot e ekspozuara janë fragmente të seteve të ndryshme që fotografja ka bërë gjatë këtyre dy viteve rrugëtim. Ek-

spozita organizohet në bashkëpunim me Rezart Jasën, koordinator i marrëveshjes "Les temps forts entre l'Albanie et la France" në kuadër të shkëmbimeve kulturore Francë-Shqipëri. Në konferencën për shtyp, drejtori i GKA, Artan Shabani vlerësoi fotografen franceze për sensibilitetin që ka shprehur ndaj vendit tonë. "Kam kënaqësinë të falënderoj Virginie Caquot, për gjithë impulsionin dhe gjithë këtë punë që kanë bërë së bashku me stafin. Fotografitë përcjellin realitetin e vendit tonë, njerëzit, natyrën, gjithçka që ka ngacmuar sytë dhe emocionet e autoritës", - theksoi Shabani.



Një prekje larg dashurisë

E ardhmja
është emocionuese.

Ready?



E DIEL
15 Tetor
2017



e-mail: milosao2005@yahoo.com

Monumentet e REALIZMIT SOCIALIST e dhunuan peizazhin...

NGA MAKS VELO*

Sa më tepër që kalon koha aq më e vështirë bëhet njohja e vërtetë e metodës së artit të Realizmit Socialist. Ajo po largohet duke fshehur me kujdes gjithë mëkatet që ka bërë.

Prandaj është e domosdoshme analiza e saj sa më e shpejtë. Arti i Realizmit Socialist i bindej vetëm vendimeve dhe udhëzimeve të Partisë. Vetëm ato i konsideronte të pagabueshme.


Në burg mendoja se kjo, metoda e Realizmit Socialist ish një farë spitali ku ideologjia marksiste i operonte dhe i u hiqte nervin artistik si shkrimtarëve ashtu dhe skulptorëve dhe piktorëve. Ashtu si spitali i burgut, ky ish spitali i artit të Realizmit Socialist. Pastaj i linte të lirë. Ky nerv që i u hiqej ishte intuita natyrale artistike.

Ajo përmban në vetvete dhe tentacione primitive dhe shtyssa të panjohura më parë, që çelën rrugët e Artit Modern.

Mbasi hiqej ky nerv këta artistë, me nerv të tredhur bëheshin hipotentë për Artin Modern.

Ata ishin të lumtur, si eunukët në pallatin e sultanit. Teoritë filozofike që duan të transformojnë rrënjësisht shoqërinë njerëzore, si Marksizmi, kanë nevojë dhe për objekte kulturi që të identifikohen në besimtarët me këtë religjion.

Më 1967 diktatori dha urdhër për mbylljen dhe shembjen e objekteve të kulteve të Krishtera dhe



MAKS VELO

SKULPTURA E REALIZMIT
SOCIALIST NË SHQIPËRI



DHE SKULPTURA NË EUROPE



Myslimane: Kishave dhe Xhamive.

Atëherë dal nga dal funksionet e qendrave të reja të kultit i morën Monumentet Skulpturore, ansamblet Arkitektonike-Skulpturore si Varrezat e Dëshmorëve, Lapidaret, po ashtu Muzeumet e L.N.C.L. dhe Galeritë e Arteve në Tiranë apo në rrethe.

Në to çoheshin në ditët e festive të reja: fëmijët e shkollave, të rinjtë e Universiteteve, punëtorët e qendrave të punës, ushtarët, fshtarët kooperativistë, për ceremoni përkujtimore.

Këto përfunduan me 6 monumentet e udhëheqësit Enver Hoxha në bronx dhe mermer, i cili kështu e shpalli veten si Mesia i ri. Këtë gjë kish bërë më parë Stalini në B.R.S.S. mbas viteve tridhjetë. Tani këtë gjë po e bënin udhëheqësi i Koresë Veriore.

Si në tempujt e Antikititit, apo Kishat, Sinagogat, Xhamitë, apo Tempujt Budistë mesjetarë dhe tani ish arti që u thir; të jetë ndërmjetësi midis ëndrrës totale të lumturisë së pritshme komuniste dhe njeriut të thjeshtë.

Ky dhe ish misionim i lartë që Partia Komuniste i ngarkoi skulptorës.

Kështu atribuohet e natyrshe të artit u denaturuan.

Arti Evropian në këtë kohë bëri të kundërtën.

Nuk pranoi asnjë mision apo nënkuptim religjioz dhe i dha liri të plotë abstraksionit.



Vijon në faqen 14

S

SKULPTURA

Skulptura e Realizmit Socialist e kthen njeriun në një "aktor dramash heroike". Kthimi i fatkeqësive aksidentale në heroizëm ishte një mashtrim, dhe në këtë mënyrë bëhej thirrje për sakrificat të tjera. Heroizmi socialist ishte një vetësakrifikim i kotë. Këto monumente gjigante përdhunojnë peizazhin, shkruan autori në botimin e tij të ri...

Skulptura e realizmit socialist

NGA MAKS VELO*

Vijon nga faqja 13

Sekretari personal i Enver Hoxhës, Musin Kroi në ditarin e tij ka shkruar:

29 Qershor 1970. - Në orën 13.00 në sallën e plenumëve ishin ekspozuar maketet për Monumentet e Pavarësisë. Shkuam bashkë me shokun Enver. U takuam me skulptorët. Shoku Enver bëri vërejtje për të përmirësuar përmbajtjen e maketit.

27 Janar 1978. - Shoku Enver dha porosi të ngrihet një bust i mirë për Isa Buletin në qytetin e Shkodrës. U ngarkua Ramizi. Shoku Enver u interesua për Monumentin e Drashovicës dhe dha porosi të bëhet një monument i mirë me kompleks luftëtarësh, ku të dalë dhe figura ime.

(Është interesant të shënojmë se Enveri jep urdhër të jetë në monument edhe figura e sekretarit të tij, si në afresket mesjetare ku krahas Krishtit janë dhe Apostujt-Shënimi imi)

9 Korrik 1979. - Thirra Muntaz Dhramin dhe e porosit për Monumentin e Drashovicës, të shohë mundësinë për ta mbaruar me rastin e 60 vjetorit të luftës së 1920. Pra, vitin 1980.

Shtator 1980. - Shoku Enver pa maketin e Monumentit të Reformës Agrare, që i a prezantoi Anastas Kondo.

Asnjë udhëheqës politik perëndimor nuk ka shkruar apo diskutuar asnjëherë në studiot e një skulptori për të dhënë udhëzime dhe sugjerime dhe urdhëra. Edhe Çurçilli që pikturonte dhe ka botuar kujtimet e veta, nuk guxoi t'u japë sugjerime artistëve të tjerë.

Enver Hoxha ka botuar një volum MBI LETËRSINË DHE ARTIN.

ART I NGUJUAR

Në gjuhën shqipe është një fjalë NGUJIM me një domethënie shumë të veçantë.


Kjo fjalë është e lidhur me ligjet e gjakmarrjes, që zbatohet edhe sot në malet e Veriut dhe quhen KANUNI I LEK DUKAGJINIT.

Ai që ka vrarë, pra që ka marrë gjakun, NGUJOHET me gjithë familjen. Nuk dalin jashtë nga frika e gjakmarrjes, kjo vlen për gjithë familjen.

Kështu dhe arti i Realizmit Socialist u NGUJUA.

Pas GJAKMARRJES së Revolucionit të Tetorit, Rusia dhe më vonë gjithë Kampi Socialist u NGUJUAN, ekonomikisht dhe kulturë.

Nga ky vetizolim, dëmin më të madh e pësoi arti që preu gjithë lidhjet me pjesën tjetër të botës. Kur doli nga NGUJIMI, ai pa se kish ngelur prapa dhe se ish një koleksion veprash që të shtien frikën.



Kur rri në mes të këtyre veprave më duket sikur jam në një cmendinë, në çmendinën komuniste. Skulptura duket sikur është dorëzuar. Si një ushtri e dorëzuar. Asnjë rryme arti më parë nuk i kish ndodhur kjo gjë.

Karakteristikat që mbart SKULPTURA MONUMENTALE dhe ajo e KAVALETIT janë:

1. Ndjenja e fallsitetit dhe e gjigandomanisë.
2. Figura janë të pajisura me vegla pune dhe armatime.
3. Mungesa e sensit artistik dhe e kërkimeve plastike.
4. Himnizimi i egërsisë.
5. Himnizimi i diktatorit Enver Hoxha.

Kjo dramë u çfaq më parë në artin Rus, ku u ndaluan dhe u shkatërruan gjithë embrionet artistike novatore. Ky ish paralajmërimi i shkatërrimit të gjithë shqërisë.

Diktaturat kërkojnë të emetojnë simbole të reja, kështu ngjau dhe me parullën vet-vrasëse: Ç'DO GJË ME FORCAT E VETA, që skulptori Muntaz Dhrami e dha me skulpturën LART FRYMËN REVOLUCIONARE.

Diktatura shtonte dozat e drogës artistike për çoroditjen morale të një populli të tërë.

Emocioni që të japin këto skulptura është ideologjik dhe jo artistik.

Ato të ngjallin ndjenjën e nënshtimit, të hiçit, të depersonalizimit, të sterilizimit mendor dhe tharjes estetike.

Intesiteti dhe drejtimi i lëvizjes së monumentit janë një nga treguesit kryesorë artistikë.

Skulptura e Antikitetit Grek apo Romak, e Mesjetës, e Rilindjes, e Klasicizmit, e Modernitetit Europian, kanë lëvizje të buta. Dhe marrëdhëniet e figurave janë plot etikë dhe butësi.

E kundërta këtu, personazhet e ngurtësuar të monumenteve janë plot mlllef, mbushur me inat tërë egërsi dhe pa edukatë.

Plastika ka agresivitetin e politikës.

Po të bëjmë një inventar të ar-



Maks Velo, vizatim i një pune të Giacometit

matimeve të skulpturave zëmë vendin e parë në Historinë e artit. Bomba, granata, gjerdhanë me fishekë, revole, pushkë, kallashnikovë, dybli, mitraloza, topa...një depo e tërë armatimesh.

Kur isha në Poloni për disa ekspozita, në Poznan pashë një muzë të armatimeve.

Armaturat Mesjetare ishin vendosur në rresht si Ushtri prej metali.

Duke shkruar në mes të rreshtave, përfytyroja duelet mesjetare trup me trup, përplasjet e falangave të rënda të kalorësisë apo këmbë-sorisë.

Por nuk di përse, diçka përbrenda më çonte drejt formave të artit



Maks Velo, vizatim i një pune të Giacometit

bashkëkohor Socrealist Shqiptar. Atëhere gjeta atë që më mوندonte: superpozimin e imazheve.

Mbi këta ushtarë mesjetarë ngriheshin heronjtë Shqiptarë deri në fyt me armatime, në bronz, që tentonin të bëheshin imazhe njerëzore (doemos historike).

Nuk shpjegoja dot si ish e mundur që këto armature bosh, pa koka, pa duar, pa këmbë, pa trupa, bosh, ishin aq të fuqishëm; më të plota, më heroikë se sa monumentet, statujat, dhe relievet gjigande ngritur në të katër anët e Shqipërisë.

Po, thashë me vete, arti ka ligje të padukshme, misterioze, të pakapshme nga artistët që marrin

urdhra nga politikanët dhe nuk ndjekin vokacionin vetiak.

* **

Diktaturat për njerëzit e thjeshtë janë sakrificë e detyruar. Por ato i quajnë heroizma.

Komunizmi nxori në plan të parë HEROIZMIN SOCIALIST, që ish sakrifikimi suprem në punë. Skulptori i Popullit K.R. boton artikullin: "Trajtimi i heroizmit masiv, tipar në skulpturën monumentale": (Drita 1984). Heroizmin masiv skulptura perëndimore nuk e përcakton si TIPAR të vetin, kurse Realizmi Socialist e cakton si TIPAR kryesor.

Skulptura e Realizmit Socialist e kthen njeriun në një "aktor dramash heroike".

Kthimi i fatkeqësive aksidentale në heroizëm ish një mashtrim, dhe në këtë mënyrë bëhej thirrje për sakrificat të tjera. Heroizmi socialist ish një vëtsakrifikim i kotë.

Këto Monumente gjigande përdhunojnë peisazhin. Shembulli më elokuent është Monumenti i Drashovicës në Lumin e Vlorës, i Skulptorit të Popullit Muntaz Dhrami.

Ato kodra aq të bukura që kanë sfond varg-male aq plastike, nuk lidhen fare me Monumentin.

Monumenti ka hyrë dhunshëm në atë peizazh, si një thikë në trupin e një njeriu.

Është pa kuptim dhe më trishtoi.

Veprat më të mira: "Nënë Shqipëri" dhe "Monumenti i Pavarësisë"

Tre artistët kryesorë që udhëhoqën skulpturën në Shqipëri ishin Kristaq Rama, Muntaz Dhrami dhe Shaban Hadëri. Të tre studiuan në B.S. në vitet 50-të. I vetmi që dallohej për një kërkim forme, një kubizëm të lehtë ish Kristaq Rama; këtë e shohim në bustin e SHOTE GALICËS në Kukës, apo portretin i ZBORISTES.

Ai influencoi pozitivisht në monumentin më të madh dhe më të rëndësishëm, atë të NËNËS SHQIPËRI në Varrezat e Dëshmorëve në Tiranë, dhe në MONUMENTIN e PAVARËSISË në Vlorë. Këto dhe janë veprat më të mira nga kjo periudhë.

LISTA E VEPRAVE KRYESORE TË SKULPTURËS MONUMENTALE:

Më 5 Maj 1949 inaugurohet Busti i QEMAL STAFËS i skulptorit Janaq Paço. Në 29 Nëntor 1949 u përrua në Tiranë MONUMENTI I PARTIZANIT i skulptorit A. Mano. Vepra u derdh në bronz në fonderinë e Uzinës Enver. Me 1950



"Nënë Shqipëri"

NGA BEN ANDONI

Përballë realizmit socialist

Nuk duhet të jenë të pakët njerëzit që e njohin Maks Velon e që duhet t'i kenë konsideruar ecjet, shtegtimet, udhëtimet dhe "humbjet" e tij të shpeshta si kapriçio artistit për të hulmuar dhe për t'i dhënë flad jetës së trazuar prej fatit të keq të dikurshëm. Në fakt, për ata pak, që e ndjekin me kureshti, jo thjesht në aktivitetin e angazhuar publicistik, por për vepërimitarinë e tij bazike, ka vend kureshtje për skicat, vizatimet që ai i sjell si dëshmi i këtyre përhumbeve kohore. Dhe, kur

ditët e fundit fondit të veprave të artit pamor i është shtuar puna e radhës së artistit "Skulptura e Realizmit Socialist", atëherë ti gjen shpjegim. Maks Velo është gati një artist me disiplinë teutonike që ka të fiksuar në kokën e tij mu si pllakat e dikurshme të Qytetërimeve të madhe të Lindjes, misionin dhe punët, por edhe të ardhmen. Koha është një nocion realisht relativ për njeriun që krijon dhe krijon.

Së fundmi, vepra e tij madhore "Skulptura e realizmit Socialist" i bën mirë të gjithë komunitetit ar-

tistik jo thjesht për dokumentimin e punëve, por për konceptimin e artit që i dha jetë skulpturës socialiste. Për Maks Velon ka një kanon, me anë të të cilit ai shpjegon artin pamor, por edhe që e bën temë debati të hapur. Zhvillimi i skulpturës tregon zhvillimin e artit të një vendi. Gjithçka kalon, humbet, e mbulon pluhuri i harresës porse skulptura ka jetë mbi shekujt dhe ajo përcjell qytetërimet përmes kohërave por edhe sfidat vetanake të artistit, që t'i tejkalojë kohërat.

A ishin të vetëdijshëm artistët

e Realizmit Socialist për këtë mision? Për Maks Velon përgjigja për ta fshihet në moralitetin artistik të shumëve syresh, qoftë shqiptar por edhe të huaj. Ai që ka dashur të ruhet prej tyre është munduar të gjejë hapësira, por vetë skulptura e "Realizmit Socialist" e kthen njeriun në një "aktor dramash heroike". *Kthimi i fatkeqësive aksidentale në heroizëm ish një mashtrim, dhe në këtë mënyrë bëhej thirrje për sakrificat të tjera. Heroizmi socialist ishte një vetësakrificim i kotë. Këto monumente gjigande përdhunojnë pei-*

sazhin", shkruan Maks Velo.

A dështoi një art i një rryme të tillë dhe çfarë dëmsh i solli Shqipërisë? Mendimet këtu ndahen por realiteti është se shumë prej këtyre veprave u krijuan në kohën e një optimizmi fals dhe parashikimeve të fryra për vendin, kurse një pjesë e artistëve e kanë të vështirë të shprehin për rrjedhën e këtij arti, sepse ishin vetë pjesëmarrës në të. Larg këtyre interesant është se kemi një punë jete nga ana e Maks Velos dhe kurorëzimin e një përpjekje që ka marrë energji, koncentrim mendimi, por edhe shumë dashuri nga artisti i njohur, që premtonte të sjellë sërish punë të mira.

Paskali punon bustin e VOJO KUSHIT. (Me qenë se mbas 1970 u rrit numri i skulpturave monumentale, në vitin 1984 u ngrit Sipërmarja e derdhjes në Bronx të veprave të artit.)

Më 1953 vendosen relievet dhe skulpturat në KINOSTUDION SHQIPËRIA E RE.

Në 1954 vendoset monumenti i STALINIT në Kombinatin e Tekstileve, vepër e O.Paskalit.

Më 1959 përurohet MONUMENTI I LENINIT i Kristina Koljakës.

Në vitin 1959 u përuhua MONUMENTI I SKËNDERBEUT në Krujë i Janaç Paços.

Shtatorja LART FRYMËN REVOLUCIONARE e Mumtaz Dhramit, ekspozohet për herë të parë në vitin 1966.

Në Gusht 1969 në Shkodër përurohet MONUMENTI I HERONJVE TË VIGUT i skulptorit Shaban Hadëri që ka puntuar për Shkodrën edhe skulpturën e ISA BULETINIT.

Në vitin 1968 në Mathauzen vendoset përmendorja PARTIZANI FITIMTAR i skulptorit Odhise Paskali.

Në Kukës në 1968 inaugurohet busti i SHOTE GALICËS, vepër e Kristaq Ramës.

Në Nëntor 1969 ngihet afër Tiranës përmendorja e MUSHQETASË e skulptorit Hektor Dule i cili është autori edhe i skulpturës NË NJË DORË KAZMËN DHE NË TJETRËN PUSHKËN. Është bashkautor edhe i MONUMENTIT TË 1920.

Më Tetor 1971 në Rrëshen u përuhua MONUMENTI I KATËR HEROINAVE TË MIRDI T'ËS, vepër e skulptorëve A. Mano, Dh. Gogollari, F.Dushku dhe P.Çuli.

(Patkeqësisht ky monument nuk egziston më është shkatëruar plotësisht në 1996).

Më 5 Maj 1972 u përuhua monumenti NËNA SHQIPËRI në Vorrezat e Dëshmorëve në Tiranë, i autorëve Kristaq Rama, Shaban Hadëri dhe Mumtaz Dhrami.

Në Nëntor 1972 në Vlorë inaugurohet MONUMENTI I PAVARËSISË, i skulptorëve Kristaq Rama, Shaban Hadëri dhe Mumtaz Dhrami.

Më 1974 inaugurohet RELIEVI në Kryeministria, vepër e Kristaq Rames.

Në qytetin e Korçës në vitin 1977 ngrihet GUERRILASIT e Kristaq Ramës.

Në vitin 1978 ngrihen bustet në bronx të VËLLEZËRVE FRASHËRI, nga O.Paskali.

Në 1978 ngrihet PËRKUJTIMORJA E BRIGATËS PARË SULMUËSE, me autor Perikli Çulin.

Në 1978 ngrihet LAPIDARI I PRISKËS, me autorë M. Dhrami dhe S.Koci.



"Monumenti i Pavarsisë"

Më 1978 përurohet ATENTATORI, relief në bronx i Th. Thomait.

Inaugurohen: ZONJA ÇURRE -Tragjas/ SHKURTE VATAMyzeqe/ RINIA E AKSIONEVE-Lukovë/ AVNI RUSTEMI-Vlorë/ PARTIZANI i O.Paskalit në Përmet.

Në varrezat e dëshmorëve të rrethit të Tropojës, më 1980 ngrihet PARTIZANI KUSHTRIMTAR, i K.Ramës.

Më 1981 në Vlorë u inaugurova



Maks Velo, vizatim

monumenti kushtuar HYSNI KAPOPOS.

Më 1981 punohen skulpturat për Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë.

Më 1982 punohen skulpturat e Muzeut të Skënderbeut në Krujë, nga Janaç Paço dhe Genc Hajdari. Në Nëntor 1982 inaugurohet në Bajram Curri, SHTATORJA E BAJRAM CURRIT, vepër e skulptorit Fuat Dushku.

Më 1984 ngrihet monumenti PRITA E BARMASHIT me autor Thoma Thomain.

Më 1984 ngrihet OBELISKU kushtuar KONGRESIT TË PARË TË BRASH-it në Helms të Skraparit.

Më 1987 në Qytetin e Lushnjës ngrihet Monumenti kushtuar REFORMËS AGRARE DHE KOLEKTIVIZIMIT TË BUJQËSISË, me autor Perikli Çuli.

Më 1982 MONUMENTI I REZISTENCËS, ngrihet në Durrës, buze detit.

Në 1988 inaugurohen në Tiranë, Korçë, Gjirokastrë, pesë monumentet e Enver Hoxhës punuar nga Sali Shijaku, Shaban Hadëri, Kristaq Rama, Thoma Thomai, Hilmi Kasemi, Hektor Dule, Mumtaz Dhrami.

SKULPTURA IME

Përveç pikturave, vizatimeve, veprave në arkitekturë, u mundova të bëj diçka edhe në skulpturë. Në Parkun e Madh, në 1963 bëra një stol-skulpturë që është akoma se nuk e kuptoi njeri dhe nuk i dhanë rëndësi. Në Hotel DRINI në 1970 bëra 5 relieve të mëdha në bakër të rrahur. Në VENDIMIN E GJYQIT thuhet: "Të huaja dhe të realizuara nën ndikimin e ideologjisë borgjeze dhe revizioniste me mjete të artit naiv, primitiv, ishin relievet e rrahura në bakër të vendosura në ambientet e hotel DRINIT në Tiranë të punuara nga i pandehuri" (Akt-Akuza faqe 3). Me vendim të gjyqit u konfiskuan dhe u dogjën 250 punime në pikturë, pastelevizime, po ashtu u shkatëruan edhe relievet në bakër të rrahur. Në burg punova në dru bushi disa koka në miniaturë. Mbas 1992 kam derdhur në bronx disa bocete të bazuara në ciklin e vizatimeve FSHATI PRIMITIV, apo nga ciklet e tjera me vizatime.

Në vitin 1991 këto monumente u hoqën zvarë dhe u shkatëruan. Ky eveniment konsiderohet edhe fillimi i Demokracisë.

Tre artistët kryesorë që udhëhoqën skulpturën në Shqipëri ishin Kristaq Rama, Mumtaz Dhrami dhe Shaban Hadëri. Të tre studiuan në B.S. në vitet 50-të.

I vetmi që dallohej për një kërkim forme, një kubizëm të lehtë ish Kristaq Rama; këtë e shohim në busti i SHOTE GALICËS në Kukës, apo portreti i ZBORISTES.

Ai influencoi pozitivisht në monumentin më të madh dhe më të rëndësishëm, atë të NËNËS SHQIPËRI në Vorrezat e Dëshmorëve



Maks Velo, vizatim

në Tiranë, dhe në MONUMENTIN e PAVARËSISË në Vlorë. Këto dhe janë veprat më të mira nga kjo periudhë. Këtë mendim shpreh edhe biografa e tij, studjuesja Suzana Varvarica. Fytyra e NËNËS ka një krenari modeste dhe të butë, kurse figura që ngrihet lart shoqërohet me një valëzim formash draperie, që shkojnë nga mbrapa dhe krijojnë ndjenjën e madhësisë së përjetëshme.

Kjo vepër është më përfaqësuesja e kësaj rryme dhe shërben si vënd pelegrinazhi.

Krahas Varrezave të Dëshmorëve në Tiranë, u sistemuan dhe u pajisën me monumente gjithë varrezat e qyteteve të tjera. Mbas 1990 Kristaq Rama bën një seri nudosh, të cilat treguan sensibilitetin e tij të lartë. Ky rast tregoi se si Realizmi Socialist deformoi detyrimisht apo vullnetarisht një artist me potencial të madh.

RELIEVET

Relievët ishin imazhet e para që u bënë mbas 1945. Janë të derdhura në çimento, allçi, më vonë derdhen dhe në bronx.

Basorelievet e para janë inkuastuar në Shtëpinë e Sindikatave në Tiranë në 1947, më vonë janë ato të Monumentit të Partizanit në Tiranë, më pas janë 14 relievet-rondo të Kinostudios Shqipëria e Re, inauguruar më 1953, pastaj vjen ai i Gjinnazit "Qemal Stafa" në Tiranë.

Në Kryeministria u bë me porosi relieve më i madh, meqenëse ish lënë që në ndërtimin e vepërës një kaseton për këtë qëllim.

Italjanët kishin paisur me relieve në travertinë dhe keramikë, Maternitetin dhe Bankën Kombëtare.

Më duket se vepra më e aritur nga ana artistike është relievi i vendosur në Rrugën e Durrësit i, në bronx me dimensione 100X125 cm. me autor Thoma Thomain, që evokon atentatin që Vasil Laçi i bëri Viktor Emanuelit, Perandorit të Italisë Fashiste.

Relievët u përdorën shumë si imazhet kryesore në vepra të kompozuar arkitekture-skulpturë, në Monumentin e Kalimit të Brigatës Parë në Veri, Monumentin e Drashovicës, në Pezë, dhe në hollin i Pallatit të Kongreseve, ku në hyrja kryesore është vendosur një skulpturë femër që zbret nga sipër si ëngjëll pa krahë.

BUSTET

Bustet e bëra nga skulptorët në këtë periudhë janë disa qindra, janë derdhur në bronx, në allçi, janë gdhëndur në mermer në gur në dru.

Për të bërë buste skulptorët shfrytëzonin çdo punëtor të shpal-



Vijon në faqen 16

→ Vizion nga faqja 15

lur hero, çdo mjelëse që tejkalon planin, çdo minator pararojë. Pastaj ish fondi pambarim i figurave historike: komitë, hoxhë, poetë e shkrimtarë të Rilindjes.

Të gjithë njëllor të tendosur me shikimin larg.

Sot bustet rrinë përkrah njëri tjetrit, njëri mbi tjetrin si në një morg.

Të duket sikur vijnë nga një epokë e largët, e pajetuar, e panjohur dhe e padëshirueshme.

Ata përfaqësojnë një epokë mecece që është marë nën hetim.

Ata janë dhe akuzuës dhe të akuzuar.

Në skulpturën Europiane të këtij shekulli, bustet gati nuk egzistojnë.

Kohët e reja kërkonin të tjera prerje deskriptive. Tani praktikohet arti total, dhe është tërësia e figurës që e plotëson këtë.

Një bust sado i mirë është një



Maks Velo, vizatim i një pune të Roden

ujë.

Në parkun e Poradecit buzë liqenit, u vendosën dy vepra të Vildan Jahjes, një BARI DUKE I RËNË FYELLIT dhe një FSHATARE NGA RAJKA.

Në Lushnjë në lulishten e qytetit u vendos skulptura rrethore e SU-



Maks Velo, vizatim i një pune të Bocconit

bust, kush më afër e kush më larg, që marshojnë, luftojnë ose parakalojnë.

Elementet e tjera janë pllakateske si vje ose parulla V.F.L.P. ose P.K.SH. ose LAVDI PEZËS HEROIKE, ose POPULLI NË KËMBË PARTIA NË BALLË. Etj.



Maks Velo, vizatim i një pune të Giacomettit

së sistemit. Dal nga dal morën një rëndësi religjioze. Krahas inaugurimeve të uzinave, fabrikave, hidrocentraleve, bëheshin edhe inaugurimet e veprave të artit me bandë muzikore, prerje shiritash, grumbullime masive, fjalime, fishekzjare, valle popullore. Arti

secilit që nuk veponte si ai. Arti i Realizmit Socialist na tregoi një rrugë të gabuar dhe na humbi në hapësirën e historisë njerëzore, se arti është si gurët milenarë që tregojnë drejtimin dhe distancën. U gabua dhe në drejtimin e ecjes dhe në llogaritjen e distancës, dhe së fundi ai (Realizmi Socialist) humbi në një lloj shkretëtire të panjohur. Tani nuk dihet ku është.

AUTORËSIA

Një numur i madh veprash janë bërë nga dy, tre apo katër autorë. Në artin perëndimor ky fenomen nuk është parë. Realizmi Socialist nuk pranoi autorësinë e artistit. Në Historinë e Artit të shek.XX-të nuk përmendet asnjë artist i Realizmit Socialist. Është rryma e Realizmit Socialist që merr autorësinë. Puna është një produkt shoqëror, thotë Mark-sizmi, dhe individi nuk ze vend. Në Kongresin e 3-të të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve më 1984, Kristaq Rama thotë:

NJË DUKURI E RE QË KA

Skulptura e realizmit socialist

fragment, artistët nuk rezikojnë me fragmente.

STATUJAT

Si në një lojë bixhozi, skulptura në këtë kohë lëviz me katër personazhe.

PARTIZANI, PUNTORI, FSHATARJA, dhe USHTARI.

Ky repertori i kufizuar human në dispozicion erdhi mbasi Vera Muhina në vitin 1930, në Moskë, bëri grupin e famshëm skulptoror PUNËTORI DHE FSHATARJA, me drapër dhe çekan, që u bë simboli figurativ i shtetit të Sovietëve, B.R.S.S.-së.

Punëtori ish gjithmonë i fuqishëm, muskulor dhe mori rolin e një figure mitologjike, që nuk përputhej me realitetin.

Kulmi arriti me figurën-simbol NË NJËRËN DORË KAZMËN DHE NË TJETRËN PUSHKËN, të Hektor Dules, ku ai tani merret përsipër edhe të punonte edhe të mbronte vëndin.

Skulptura në këto moment arriti indoktrinimin më të madh, ajo u bë ushqimi i kondensuar ideologjik më i preferuari, që partia i jepte popullit.

Grupi tjetër që u bë emblema e kohës ish LART FRYMËN REVOLUCIONARE I M.Dhramit.

Sa më shumë që ekonomia binte poshtë, aq më tepër skulpturat ngriheshin lart.

Por ajo që ish më e rënda dhe më kuriozja, ish devijimi inkohsient i njeriut natyral në njeri fikson, sipas modelit të zgjedhur artistik-isht.

Njerzit mernin pozat e skulpturave, buzëqeshnin si personazhet e pikturave, dhe silleshin në jetë si heronjtë e filmave të kinostudios.

Ky është dëmi më i madh që arti i shkaktonte njeriut, kur e denatroyron.

SKULPTURA E PARKUT

Në parqet e Tiranës dhe disa qyteve u ngritën disa monumente që nuk dallojnë nga skulptura politike.

Në Tirane u vendosën dy skulptura ne Parkune Madh, ajo e FEMLJEVE DUKE LUAJTUR KALUÇ e Sofokli Kocit, dhe PARTIZANI DUKE PIRË UJË e Hektor Dules, ku paraqitet një partisan dhe një fshatarë që i ka ofruar stomnën me

ZANA VARVARICËS, një grup pionierësh duke kërcyer.

Në Sarandë buzë detit në lulishten u vendos MLEDHËSJA E PAMBUKUT.

Në shumë parqe janë vendosur buste heronjsh të luftës apo ideologjive të Rilindjes.

Po ato tema po ato permasa, po ato materiale, si në skulpturën monumentale.

GRAVITACIONI

Të gjitha kryeveprat e skulpturës antike, të rilindjes, apo moderne, kanë një gravitacion të brendshëm. Lëvizjet, masat, linjat, kurbat, figuracioni, të gjitha lëvizin, por shkonin brënda, këshu vepra ruan sekretin, magjinë e saj. Spektatori duhet ta kërkojë.

Kurse veprat e Soc-Realizmit kanë të kundërtën: gravitacionin e jashtëm.

Këmbët janë të hapura, krahët janë të ngritura lart, dhe mbajnë vegla dhe armatime në duar.

Të gjitha pjesët vërtiten si në një karusel dhe kërkohen të çlirohen e të hidhen larg, të sulen dihen, të shpërthejnë si granata.

SURREALIZMI PEZAK.

Në një fshat afër kryeqytetit, Tiranës, në Pezë, është ngritur kompleksi më i madh skulptoror e memorial i artit të Realizmit Socialist. Në këtë fshat në 1942 u zhvillua një konferencë e gjithë grupeve dhe partive që ishin në Shqipëri në atë kohë.

Për nder të saj është ngritur një lapidar ku elementi kryesor vertikal është një kullonë me yll dhe një pushkë gjigande. Më vonë u realizua edhe monumenti në bronx i Myslim Pezës, udhëheqësit të krahinës. Pastaj u ngrit një memorial për dëshmorët e Brigadës së XII Sulmuese. Mbasandaj në bronx u derdh një memorial skulptoror; që kulmon kompleksin e Vorrezave të Dëshmorëve. Të katër këto vepra janë ngritur në një territor prej 5000 metrash katrore. Vepra e pestë është një skulpturë sinjal e Mumtaz Dhramit, ngritur në rrugën nacionale, që shënon drejtimin e fshatit, 6 km. larg.

Relievat e gdhëndura janë si grafika në linoleum, prej tyre dalin vargje figurash të plota ose deri në

Kuptohet se funksionet thjesht e pastër artistike largohen dhe pamundësohen dhe veprat marin për-sipër detyra dhetribute që nuk kanë lidhje me artin, por me propagandën e shkruar. Kush dëshiron të studiojë skulpturën e Realizmit Socialist, mjafton të vizitojë këtë fshat skulptorë. Këto vepra u ngritën për 20 vjet, nga viti 1965 deri më 1985.

Këto vite shënojnë rënien e vazhdueshme të ekonomisë dhe veçanërisht varfërimin e fshatit socialist që e përjetuan edhe pezakët. Sa më shumë që ekonomia binte teposhtë dhe sa më shumë që izolohej vëndi aq më tepër stoheshin monumentet. Peza është rast unikal në Ballkan dhe duhet ruajtur me kujdes. Monumentet e Enver Hoxhës ishin monumentet e fundit që u ngritën. Mbas katër vitesh u rrezuan dhe u hoqën zvarrë. Përrurimet e këtyre veprave bëheshin me ceremonira madhështore. Komunisti kish si ritual që në intervale të mirëlllogaritura kohore bënte inaugurime.

Zakonisht kjo ish një periudhë dy vjeçare. Ato shërbenin si justifikim i padiskutueshëm i epërësia

merte pjesë në maramëndjen e njerëzve.

Sistemi nuk linte shteg për diskutime vlerash artistike. Ato ishin vepra të Partisë dhe asnjë nuk mund të diskutonte. Religjonet herë mbas here certifikojnë mrekullitë, që të mbajnë në këmbë sistemin. Udhëheqësit komunistë me përrurimet certifikonin rregjimin, që vetdeklaroheshin si vetmi rend botëror human.

Arti ka qënë dhe mbetet lirik o tragjik. Por tragjika nuk përjetohet si dramë dhe aq më tepër si dramë shoqërore.

Realizmin Socialist, Bolshhevizmi e donte për "gjakmarrje artistike", dhe kjo shpjegon deri atë tension të jashtëm që shprehin figurat skulptorore të drejtura kundër dikujt.

Ai dikushi është fajtori, armiku i klasës, dhe prandaj duhet të jemi të armatosur deri në dhëmbë. Tragjilkja klasike është një dualizëm i brendshëm, është konflikti i luftës mes së mirës dhe të keqes, pa akuzuar njeri. Realizmi Socialist ish prokuroria artistike, që ngriti akuzat kundrejt

DHËNË REZULTATE POZITIVE NË REALIZMIN E VEPRAVE TË MËDHA KA QËNË AJO E ANGAZHIMIT M E V E KOLEKTIVE... FLET PËR NJË TIPAR TË RI TË KRIJUESVE TANË, PËR ATË TË FORMIMIT EDHE TE KRIJËSIT TË NDËRGJEGJES SË KOLEKTIVITETIT SOCIALIST... Këtë më mirë se kushdo nga udhëheqësit Komunistë e formuloi Kryeministri Shqiptar Mehmet Shehu më 1973 kur tha: "ASGJË PERSONALE NË ART".

Nuk egzistonte asnjë ligj për mbrojtjen e të drejtave të autorit. Plagjiatura nuk dënohej, në të kundërtën për krahej.

Brënda Kampit në këtë periudhë duhet të kenë punuar mbi 5000 (numur aproksimativ) piktorë, grafistë dhe skulptorë, por asnjë nga këta sot nuk njihet me emër.

Të vetmit janë Brankusi, Zadkinë, Archipenko, Kandinski, Gorki, Chagall, Gabo, Pevsner, Poliakoff, se këta u larguan në Perëndim.

Tani skulptorët Shqiptarë kanë turp nga veprat e tyre, nuk i pranojnë ato.

Ky ish një fenomen i panjohur më parë se gjithmonë artisti e ka adhuruar punën e vet.

I vetmi rast që kam takuar një grup skulptoror në Perëndim si në veprat tona të Realizmit Socialist ish i një autori meksikanas Francisco Zuniga me grupin skulptoror GRATË, punuar më 1974, ku prezantohen katër gra dhe një fëmijë të tensionuara, në gjëndje alarmi.

Mu duk sikur ish bërë në Shqipëri. Në fakt konditat sociale ish-in të përafërta dhe Meksika ish i vetmi vënd Perëndimor që përqafoi pjesërisht këtë metodë.

Kujt mund ti ngarkosh fajin metodës apo artistit?

Metoda e gabuar apo artisti inkohsient, i papërgjegjshëm?

Aq më tepër që nuk duan të dorëzojnë titujt dhe dekoratat që kanë marë me këto vepra. Veprat i mohojnë po dekoratat i mbajnë. Partia u jepte skulptorëve titujt dhe dekoratat. Titujt ishin SKULP-



"Partizani fitimtar"

TOR I POPULLIT dhe SKULPTOR I MERITUAR, mua më ngjanin si gradime ushtarakësh GJENERAL KOLONEL dhe GJENERAL MAJOR.

Pikturat e konsideruara armiqësore u dogjën, skulpturat nudo u shkatëruan dhe nuk mbeti gjurmë. Kjo ngjau vetëm në Shqipëri, në asnjë vënd tjetër të Kampit Komunist, bile as Hitleri nuk i dogji veprat e artit që i konsideroi të degjeneruara.

Vetëm muzika në Kampin Komunist shpëtoi nga shkatërrimi sepse partiturat mund të luhen edhe mbas 100 vitesh. Asnjë kompozitor nuk është dënuar me burg, se muzika nuk kapet, nuk ka lëndë, është efemere. Skulptura është poezia e materies dhe detyrimisht është shprehje individuale.

Por qëllimi ish diabolik, duke i hequr poezinë skulpturës mbetjet vetëm materialit, që duhej formuar sipas urdhrave.

Në fakt monumentet ishin skena të ngurtësuar që afroreshin më tepër me teatrin.

Skulptura u kthye në një libër historie me herojn luftëtarë, heronj të punës, dhe sigurisht mbi të gjithë diktatorin Enver Hoxha për të cilin u ngritën 6 Monumente përveç busteve.

Në Europe skulptura e personazhve ish tejkaluar.

Gjithmonë më ka bërë të mendohem ai "kujdes" i veçantë i pushtetit komunist për Letërsinë dhe Artet. Ishte në rend të dytë pas Ushtrisë dhe Sigurimit.

Komunizmi bazohej në Ushtria dhe Propaganda. Është e vështirë të dallosh kush e kish prioritetin. Mesa duket Ushtria ish për tu mbrojtur nga jashtë, kurse Artet dhe Letërsia për krijimin e imazhit iluziv të mrekullisë të brëndëshme.

SURREALIZMI SOCIALIST

Surrealizmi në artin përëndimor ish në Muze, kurse jeta jonë ish një surrealizëm i vërtetë.

Kjo dhe ish detyra e artit, dhe e skulpturës. Grupet dhe monumentet e kësaj periudhe japin një botë surreale, e cila nuk kish lidhje fare me realitetin.

Kështu e formulova që në Maj 2002, mbasi vizitova Ekspozitën REVOLUCJONI SURREALIST në Muzeun e Artit Modern në Paris.

"Arti Soc-Realist e kish më të lehtë të kthehej mbrapa në një art tjetër "Revolucionar" si surrealizmi për të kërkuar pikat e takimit me të..."

Asnjëherë nuk ka pasur një ekspozim kaq mashtues, kaq jo të vërtetë, kaq fallc, në skulpturë sa në këtë periudhë. Jeta ish tjetër dhe arti ish tjetër.

Arti donte të hiqej sikur ish jeta vetë. Njerëzit e pangrënë, kënaqeshin duke parë skulpturat në bronx, dhe ishin të lumtur.

Në fakt Komunizmi ish në buzë të greminës. Mbas pesë vitesh ai shëmbet vetë, ky kolos gjigand bie si një skulpturë balte e pa derdhur në bronx.

Isha në Spaç, zbritem nga galeria. Ishim në "VATHA", vëndi ku qëndronim para se të numuroheshim, e të hynim në kamp. Po shihja nga përroi...kur në guri para meje ish një brumbull, nuk lëviste.

U ula, po e shihja...ish skelet brumbulli. Insekti ish tharë dhe kish mbetur karkasi.

E mora me delikatesë dhe e vura mbi parmakun e drurit: "ja kështu thashë me vete, kështu është katandisur komunizmi...bosh...i tharë...i ka mbetur vetëm karkasi...po, po, ky karkasi i tharë

është arti ai do të mbulohej nga arti...këto janë monumentet e Realizmit Socialist..."

Ai dështoi në Ekonomi dhe Ushtri dhe donte të mbahej në këmbë nga propaganda ku rolin kryesor e kish Skulptura Monumentale.

Në vitin 1984 mbahet Kongresi i 3-të i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistave. Isha në burg, zhvillimet e saj i pashë në televizor.

Sekretari i Përgjithshëm Kujtim Buza mban referatin VEPRA TË SKULPTURËS SONË MONUMENTALE.

Aty ndër të tjerash ai thotë: "Lulëzimi i artit monumental lidhet me epoka të zhvillimit dhe të përparimit shoqëror... Skulptura jonë monumentale mbështetur në metodën e artit tonë revolucionar të realizmit socialist, thelloi më shumë përmbajtjen dhe rroku në thell problemet më të rëndësishme, që shprehin tiparet më të shquara, vitalitetin e atdheut tonë socialist, qëndresën, shpirtin e sakrificës dhe heroizmin, besnikërinë etj...etj...". Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistave kish një organizim vertikal, kryetari Dritëro Agolli ish anëtar i Komitetit Qëndror të Partisë dhe Deputet. Sekretari i Përgjithshëm Kujtim Buza, ish Deputet. Ky edhe mbante lidhjet direkte me Ministrinë e Brëndëshme. Ish Kryecensori i gjithë arteve figurative. Ai kryesoi grupin e Ekspertëve për AKT-EKSPERTIZËN e veprave të mija në gjykimin tim, dhe djegej dhe shkatërrimin e veprave.

Në Kongresin e 3-të diskutuan: Mumtaz Dhrami/Shaban Hadëri: FORCIMI I FRYMËS KOMBËTARE/ Avni Bilbili: PASQYRIMI REALIST I HEROIT/ Perikli Çuli: PORTRETI NË SKULPTURË/ Muharem Turkeshi: QERAMIKA DHE JETA/ Hektor Dule: DINAMIZMI.../Perikli Papa: RELIEVI GJINI QË SHPREH BRENDA TË GJËRË/ Kristaq Rama: SKULPTURA MONUMENTALE-SINTEZË E MENDIMIT REVOLUCIONAR/

Skulptori i Popullit Hektor Dule mban diskutimin DINAMIZMITIPAR I SKULPTURËS SONË TË REALIZMIT SOCIALIST. Ai thotë: "Nga buron dinamizmi në këto vepra? Së pari nga fakti që figura apo figurat që përbejnë veprat, janë kapur në moment të përshatësme për ta dhënë këtë dinamikë... Edhe ana e jashtme e lëvizjes, e ritmit, e tendosjes, e shpërthimit, luan një rol shumë të madh."

Partia, Lidhja e Artistave kërkonin që me patjetër që skulptorët të shpreheshin edhe teorikisht.

Kështu unifikoheshin shijet, kërkesat, tematikat. Çdo gjë ish diskutuar dhe aprovuar dhe të gjithë duhet tashmë t'i zbatonin.

Asnjë kongres nuk kanë bërë skulptorët Europianë. Vetëm kanë punuar, secili më vete, secili ndryshe. Vetëm kështu bëhet arti, në vetmi.

Pas 1990 me ardhjen e Demokracisë, mendova që kjo metodë do shuaj fare, por jo, nuk ndodhi kështu, përkundrazi ajo u ringjall.

Mbas vitit 2000, disa skulptorë të kësaj shkolle, kanë realizuar një numur të madh veprash me porosi të vendosura në Kosovë dhe në ish Republikën e Maqedonisë.

Janë luftëtarë me kallashnikovë dhe me dylibi të varura në qafë, vepra pa asnjë vlerë artistike.

Tani pra u bëmë vend ekspozitës i Realizmit Socialist.

Parathënia e "Skulpturës së Realizmit Socialist në Shqipëri". Botohet me lejen e autorit

P

PUBLICISTIKA

Vjen vëllimi i tretë i shkrimeve të Gjergj Bubanit. Këtë herë prezantimin e tij e bëjmë me bashkëkohësin e tij Kuteli. Në vend të parathënies, ai shpjegon më mirë se kushdo natyrën e punës së tij.



Kushtuar pamfletit shqiptar: Brumbulli Disa fjalë përmi pathologjinë politike-shoqërore dhe përmi hirurgjinë gazetare

NGA MITRUSH KUTELI

Jeta politike dhe shoqërore e një populli prezenton edhe pjesa pozitive, edhe pjesa negative: një zinxhir me veriga prej drite edhe prej errësire.

Fatqeqësisht, shumë herë, manifestacionet pozitive nuk janë përveçse atome ultramikroskopike përpara dallgëve të dyshimita që mbytin, ndalojnë zhvillimin normal edhe rrezojnë të arthmin.

Shumë herë mjafton që përmi masën e rraskapitur të qytetarëve të shtrohet një frymë lodhjeje dhe indiference për jetën publike dhe era e fatalitetit hap portën për taboret e një oportunizmi skandalos edhe pa skrupull.

Një minoritet i formuar prej bykut të shoqërisë, një minoritet që gjuan në ujrat e turbullta të interesit privat dhe që vërtitet rreth strumbullarit të fitimit, i ngritur në ofiqe të lartë, munt t'i sjellë kombit dëme më të mëdhenj sesa ato që munt t'i sjellë edhe armiku. Shumë herë është më lehtë të mpruhesh prej armikut, sesa prej atij që e mbeson mik...

Mjetet për të shpëlarë jetën dhe atmosferën publike prej këtij balasti të dëmshëm mund të ndryshojnë midis tyre, megjithëse qëllimi është gjith'ay.

Shkurtazi mund t'i ndajmë këto mjete në dy: një mënyrë direkte edhe një tjetër indirekte. Edhe e para mënyrë - e cila re-

alizohej me anën e një grushti të fortë prej burri shteti - sa edhe e dyta - e cila realizohej me anën e shtypit - lypin fuqi pozitive intelektuale dhe shpirtërore.

Më poshtë do flasim për mënyrën e dytë, e cila munt të veshë ose një formë të ngadalshme - me formimin e një ndërgjegjeje publike të kthjelltë - ose një formë arrogante: pamfleti.

Pamfleti është një zjarr që derdhet prej një shpirti të math, i

cili i shikon padrejtësitë dhe i urren. Ay përvëlton objektin kundrejt të cilit vërtit shigjetat e "muzës" ahmarëse, turgun inkapaçitetin në robëri e tropshme të nulitetit varfanjak edhe e fshikullon me helmën e frazës.


Pamfletari përdor shumë herë më të hidhurat ekspresione të gjuhës duke prekur edhe trivialin. Pa fjalë se ndryshe rrjedhjet nuk munt të jenë pozitive: armiku nuk goditet as me mule e as me doreza të mëndafshta.

I këllill qëllim shpëtimtar pati armatosur në kohën e kaluar një Aristophan ose një Juvenal, një Rabelais ose një Cervantes (Krijonjësi i legjendarit kavaler Don Quichote dela Mancha), një Voltaire edhe më vonë pati njomur me helm pendën e të frikshmit Henri Rochfort (me anën e fletores "La lanterne") qindvjetori i të cilit u festua përpara një muaji.

Nga të rinjtë mund të kujtojmë italianin Giovanni Papini, autori paradoksal i "Stronculture" edhe "Storia di Cristo", francezin Leon Daudet ose rumunët Jorga edhe Argezi.

Në shqipen tonë munt të kemi mburjen e hidhur se kemi një faunë pamfleti relativisht të madhe. Vuajtjet e panumërta të së shkuarës edhe të tanishmës patnë shtrënguar shumë shkronjëtorët të vishen me këtë armë.

Në kohën kur ndërgjegjia kombëtare ish oftikosur prej Stam-



Skeda
Titulli: Vepra e zgjedhur III
Autor: Gjergj Bubani
Redaktor: Loredan Bubani
Faqe: 456
Botim: OMSCA-1



Vijon në faqen 19

→ **Vijon nga faqja 18**

bollit e prej Athinës, shigjetat e patriotëve kishin si objekt këto dy qëndra edhe influencat e tyre shkatërronjëse. Vëzhgonjësi i fletoreve dhe i kalendareve të vjetër ka rastin të hasë epithetet më të frikëshme për Fanarin, Portën e Naltë dhe agjentët e tyre. Fletorja "Drita" që dilte në Sofje, kish, përveç drejtorit të saj Shahin Kolonja, bashkëpunëtorë panfletarë arrogantë.

I ndyeri veteran Mihal Grameno ka qënë një pamfletar i shkëlqyeshmë jo vetëm i shkrimit, po edhe i fjalës. Ay pat krijuar veprën "Malkimi i gjuhës shqipe", si edhe vargun e artikujve përmi "Honxho - Bonxhot", tek përvëlton frymën oportuniste të bykut të memorëve arnaut-otomanë. Po asnjë nga pamfletarët shqipëtarë nuk ka arrirë kulmin eksuberant të prekur prej BRUMBULLIT.

Njohës praktik dhe psikolog i fellë i gradës së zhvillimit të përgjithshëm të popullit shqipëtar, mundi të identifikohet me aspiracionet dhe vuajtjet e tij dhe pastaj të shtrijdhë në një formë kosenkuente vuajtjet dhe zemërimin e përgjithshëm.

I lindur poet, me imagjinacion të rrallë dhe me frymë inventive, mundi të drejtojë talentin e tij në luftën për pastrimin e jetës shoqërore dhe politike nga marsmi i dëmshëm që e zotëron.

Dyke qënë se mënyra më "ad hoc" për të përhapurit të pamfletit është sot forma e vjershës, e zgjodhi atë dhe e kultivoi me një mjeshhtëri të rrallë.

Në kohën e fundit pati rastin të na provojë se mund të hedhë shtizat e satirës jo vetëm me harkun e poezisë dhe të një proze gazetare elegante, po edhe me anën e formës letrare, si në komedinë "Komunisma e Korçës".

Brumbulli është sot gazetari që lëçitet integral dhe me shumë interes në Shqipëri dhe jashtë. Në një anketë personale, midis shumë lëçitësve mësova se shtylla që lëçitet herën e parë në fletoren "Shqipëria e Re" është shtylla "brumbullore". Pamfleti i Brumbullit është një kontestim i pamëshirshëm i jetës politike.

Shërbimi që i sjell përparimit tonë, është një realitet i pakontestuarshmë dhe vetëm subjektiviteti miop i disave "objekte" përpjetic të mos e vështrojë.

Nga disa numura të vjetra të "Shqipërisë së Re", të cilat i hasa rastësisht, do radhos më poshtë pak fije nga shigjetat brumbullore. Ja se qysh karakterizon atmosferën politike inkonsistente dhe me përdredhje misterioze. Çekrezit, i cili pak kohë pas burgimi, emërohej në një nëpunësi të naltë, i thotë:

"Dje të shpinin për gjykim Rreth përçark me bajoneta, Sot të hipin në Diktim, T'i gjykosh, or tungjatjeta!"

Ose, tjetër herë:
Një gradim e dy dënime,
Dy dënime e tre gradime.

Dhe për të pasqyruar gjendjen anemike të revistës "Ora":

"Dje të thoshin Telegraf
Dhe e nxirrinj pallën fora,
Sot prej goje s'nxjerr një

llaf
Se ta thonë emrin... Ora"

Kur është fjala për parlamen-

tarët tanë, penda e Brumbullit nuk njomet në ngjyrë po në helm. Satira "Sikur t'isha deputet" dihet përjashta prej më të shumëve nga lëçitësit:

"Sikur t'isha, vaj medet,
Sikur t'isha deputet..."

Për "simpatikun" prefekt "neoshqipëtar" ka gjithënjë shtija të mprehta:

"Korça na u bë gërmadhe
Edhe mi gërmadhit rri
Si ndonjë Neron i ri
Me kuror' prej misërishta
Abedini Nepravishta"
Më parë pat parodizuar këngën "Ububu, moj nëno":

"As ububu moj nëno,
Në Korçë s'mund të vij
...E di se nëpër male
Katilë s'gjenden sot,
Se dale me nga dale
U mbushnë zyrat plot..."
Në prozë kolumna "Fjalë në erë" përmban fshikulla arrogante të pamfletit brumbullor.

Se një kretin i interesuar munt ta quajë "shejtan", se një pseudo-intelektual me shpirt varfanjak munt t'a quajë "karagjos" ose "pa kripë", se një oportunist negativ munt ta quajë "të rrezikshëm", rrufeja e Brumbullit vazhdon veprën e saj hirurgjike.

Pamfleti brumbullor është një art, një ekspresion etik i gjendjes së sotme, është dhembja e përgjithshme e shkuar nëpër prizmen e një fryme komplekse. Po nuk mjafton kaq. Midis pamfletit përgjithësisht edhe pamfletit brumbullor është edhe një ndryshim.

Midis radhëve plot rrufe dhe shigjeta shkëlqejnë lotë dhembjeje, një dhembje e singërtë njëzore:

... "Kallamoq në s'ka mile-

ti

Në lot poker deputeti..."

Ose:

"Ari ynë shkon e shket kapërcenë të thellin det

edhe vete në... kurbet"

Tjetër herë:

"Gjersa të mbarohen for-

mat

Dhe të vijin' ato reformat,

Nuk është çudi për besë

Bujk më këmbë të mos mb-

esë"

Poezia brumbullore është një qeshje e mbytur në lot. Brumbulli thotë duke qeshur gjëra të cilat lipset t'i lëçitim duke qarë...

Duke lëçitur këto fije sugjestive nga dhembjet tona kolektive, më kujtohen ditët mistike të verës, kur rrezet e djellit përdridhen me pikat e shiut, më kujtohet nënëqeshja e një foshnje gepallat e së cilës janë plot lotë.

Një poet i anëve të Seine-s pasqyrore kësilloj këtë gjendje shpirtërore tragjike:

...et quand je pleure je ris,
Et puis rigole, rigole!

Vështroni me vëretjtje: në lotët dhe gajasjet brumbullore pasqyrohet më e tmerrshmjia tragjedi e kësaj epoke udhëkryqje...

M. Kuteli. "Shqipëria e re", viti 1931, Nr. 459. Biblioteka e Akademi-së së Shkencave Bukuresht, Rumani

1) ...Kur qaj, un' edhe qesh,
bëj dhe qyfyre e shaka!

A

ARGUMENT

Dritëro Agolli, mes shqiptarit Rrapo dhe Memo

NGA SHPËTIM ÇUÇKA

8. Vijon nga numri i shkuar

Përveç dhe përtej romanit "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" proza e D. Agollit e periudhës socialiste, ndër të tjera të romani "Njeriu me top" dhe të vëllimi me tregime "Zhurma e erërave të dikurshme", ngjall interes si për mesazhet (që burrojnë nga tematika por jo vetëm), ashtu edhe për galerinë e personazheve, madje për tipologjinë e tyre. Tematikat kryesore janë Lufta Nacionalçlirimtare dhe jeta e shoqërisë së dalë nga lufta, ndërsa galeria e personazheve ndahet, në përgjithësi, në tri grupe: dy të mëdha dhe një i vogël. Grupet e mëdha janë ato, që në mënyrë skematike, do të emërtoheshin "grupi i njerëzve të mirë" dhe "grupi i njerëzve jo të mirë". Grupi i vogël, fare i veçantë, është ai i një shtrese intelektualësh qytetas, që shfaqen – në këtë apo atë formë, në këtë apo atë përbërje – në mjaft nga veprat në prozë të D. Agollit.

Tematika e luftës, e shtjelluar në trajta dhe në episode të ndryshme, na sjell të tilla tablo, të cilat ndaj realitetit kanë po atë raport që ka edhe piktura e mirë dhe mjeshtërore realiste ndaj peizazhit real. Ne nuk mund të themi dot kurrë në ka pasur në realitet njerëz të tillë si Mato Gruda, kapedan Kadri Gurra, Hazir Shipshani, Nënë Hajrije Çeremi në njërin grup apo Qenam bej Ormani e të tjerë të ngjashëm në grupin tjetër, apo si Festim Çuçua në shtresën e vockël të intelektualëve qytetas.

Shpirti i autorit anon nga figurat e grupit të parë, me të gjitha huqet që ata mund të kenë. Ai synon t'ia paraqesë lexuesit të gjithë gamën e përjetimeve të këtyre figurave tipike shqiptare në rrugëtimin e tyre të vështirë drejt pjekjes së ndërgjegjes shoqërore. Nëse proza e D. Agollit ka diçka thellësisht të bukur, sepse pastërtisht të mirë, kjo

Tematika e luftës, e shtjelluar në trajta dhe në episode të ndryshme, na sjell të tilla tablo, të cilat ndaj realitetit kanë po atë raport që ka edhe piktura e mirë dhe mjeshtërore realiste ndaj peizazhit real. Ne nuk mund të themi dot kurrë në ka pasur në realitet njerëz të tillë si Mato Gruda, kapedan Kadri Gurra, Hazir Shipshani, Nënë Hajrije Çeremi në njërin grup apo Qenam bej Ormani e të tjerë të ngjashëm në grupin tjetër, apo si Festim Çuçua në shtresën e vockël të intelektualëve qytetas.

qëndron pikërisht në këtë shndërrim të thellë të botës shpirtërore të shqiptarit të thjeshtë, i cili bën një jetë plot rropatje.

Dhe po kështu me realizëm të ashpër, ndonëse jo me cinizëm, autori pikturon figurat e grupit të dytë, të cilët për shkak të një vargu faktorësh (jo vetëm objektiv) janë të padëshiruar për botën shqiptare. Ja si shprehet autori për këtë grup të dytë figurash:

"Po, ka një takëm që në kohën e Turqisë kanë qënë kapedanë të saj, në kohën e Zogut trima të tij, në kohën e Italisë sejmën dhe sahanlëpirës dhe kurrë nuk i kanë kthyer sytë nga Shqipëria!"

Pohim që tingëllojnë si një sfidë e vërtetë për një pjesë studiuesish dhe gjojastudiuesish të historisë! Dhe sa për qëndrimin e Dritëro Agollit ndaj asaj shtresëze intelektualësh të qytetit, për të cilën, sikurse del në vende të ndryshme të krijimtarisë së tij, ai thellë-thellë ndiente neveri, sa për mënyrën se si e shihnte ai këtë grupim të vockël krijuesish e njerëzish të artit ose rreth artit e kulturës, mund të mjaftojë kjo pjesë nga tregimi "Njeriu i kohës" (1986), ku flitet për disa tipare të personazhit Festim Çuço:

"...kishte përpunuar një stil

sjelljeje me nihilizëm, me pak ftohtësi, me pak snobizëm dhe me pak ironi në buzët e tij që i lëvizte me elegancë dhe bënte herë pas here me përcchim: 'pëh!', duke tundur dorën në erë. Këto veti, sipas tij, janë të domosdoshme për njeriun kontemporan".

Tërheqin vëmendjen fjalët "nihilizëm", "ftohtësi", "snobizëm", "ironi", "elegancë", "përcchim", "kontemporan".

Sot e kemi (ndoshta!?) më të qartë vlerën reale, konkrete – në jetën tonë shoqërore – të këtyre nocioneve, peshën dhe rolin e tyre në moralin qytetar, mënyrën dhe masën, me të cilën ato ndikojnë në shëndoshjen a helmimin e klimës së përgjithshme të marrëdhënieve në shoqëri.

Dhe mund të çmojmë më mirë në kishte të drejtë Dritëro Agolli, kur na përcillte të tilla mesazhe.

9. Përpara se të mbyllim këtë pjesë kushtuar veprave në prozë të Dritëro Agollit, nuk mund të mos ndalemi të krijimi, që është pa asnjë dyshim më i miri. Më i miri për nga bota e ideve, bota e personazheve, strukturimi, stili dhe gjuha. Dhe, pavarësisht karakterit të skalitur e tejet epik, si gur i palat-





...nga numri i shkruar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Arsyeya ishte se kishim shumë shkrimesh të natyrave të ndryshme. Për fat të keq mungonte poezia. Ka kohë që për shkak të shkrimeve kilometrike nuk kemi pasur vend për krijimtarinë. E pamundur të gjendet ekulibri në pak rreshta. Ke ndjesinë sikur shkruan në një format tip të tjetër-i, ku autori është krejt i kufizuar. Gjithsesi gjetja e Irakli Koçollari i përkiste një piktori të njohur nga Vlora, që kish të jetuar shëkur më parë. Në fillimet e shekullit të XV, Mikele da Valona, që kish të mbërritur në brigjet latine nga Shqipëria, shkoi dhe u vendos në Abruzzo dhe prej këtu qarkulloi në terrenet sa venore dhe jugore, në Akulla - Foxhia, shkoi edhe më tej në Molise, ku punoi në Komplexin e Kolegjit të Santa Maria Maxhores, të Xhullonezes, ndoshta edhe

më gjërë, por të paktën në këto anë në gjejmë edhe sot punimet e tij murale dhe në tela, sigurisht me tematikë religjioze dhe të dedikuara në objektet e kultit. Shkrimi ishte shkruar me pak gjatësi, por nëse do kish të pak elementë fiksheni brenda do të ishte tejet tërheqës. Shpëtim Çuçka do të vijojë për disa numra me shkrimin e tij studimor për Dritëro Agollin. Autori, në këtë copëz, hedh një vështrim për mëdyshtjen e autorit. "Një vlerësim i gjithanshëm dhe i vëmendshëm, pa kufizime dhe metafizikë botëkunditore, do të gjejë pajtëtarë - dhe pa shumë vështirësi - thelbin e tyre: Ilamujt e ëndrrës së madhe të çlirimit të vendit dhe të një shoqërie të mbështetur mbi parimet e barazisë dhe drejtësisë shoqërore, Ilamujt e ëndrrës së djalësisë, rinisë dhe burrënisë, në fakt të të gjithë jetës, së Dritëro Agollit, Ilamujt që ai i ka mbajtur përmes vështirësive dhe kurrë

nuk i ka hedhur, as në klimën e një kohe të saktë, të shkretëtirës", shkruan autori... Redaktori shtoi një shkrim të vetin për Elsie, që e vlerësonte për punën dhe përkushtimin e vet. E gjithë kjo punë e tij, më shumë pati jehonë ndër të huaj sesa vendasit. Këta të fundit e vlerësonin, më së shumti, kur ai i përmendte në punët e tij ose i përkthente. Në rast se nuk e bënte këtë, ai ishte thjesht një Robert Elsie, një qytetar kanadez me origjinë gjermane, që dinte mirë anglisht. Sa ishte gjallë, besoj se të rrallë do kenë qenë shqiptarët që do e kenë pyetur ndonjëherë: Po në si mund të ndihmojmë?! Ne nuk e bëmë sepse jemi të interesuar thjesht për egon tonë dhe sëmundjen kombëtare për të qenë në qendër të gjithçkaje. Pra, tani ta lemë të qetë Elsie! Se për ta harruar do e harrojmë sa të futet në dhe. Rrëfimi lexohet këndshëm sepse për-

ban shumë elementë dokumentarë, që lidhen me autorin dhe kujtimin e një Tirane që nuk do të kthehet më..., shkroi redaktori për një rrefim të Merita Shkupit, që për hir të së vërtetës ishte shumë interesant. Kësaj i shtoj një shkrim, ku redaktori ishte vetë pjesëmarrës në Prizren në një aktivitet kulturor. Diplomacia si art i politikës së jashtme të një shteti ndaj shteteve tjera, është rregulluese e raporteve, interesave të përgjithshme për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të shteteve në çdo sferë: politike, ekonomike, kulturore dhe të tjera... Redaktori botoi dhe një pjesë të Sonnenschein të Dasha Drndic, në shenjë respekti për ditën e përkthimit, një ditë ku përkthyesit nuk ndihen aq shumë të begenisur. Një numër relativisht i mirë, por që meritonte shumë më tepër. Layout mezi e mbylli këtë numër.

uar, të burrit shqiptar Rrapo Tabani, pavarësisht bukurive të larmishme të veprës, figura e komisarit Memo është në qendër të gjithë frymës së librit, është vetë fryma e tij. Historia e Luftës nacionalçlirimtare e ka një figurë të ngjashme, atë të Memo Metos: poet-luftëtar, Hero i Popullit.

E gjithë mjeshhtëria e Dritëro Agollit, në të gjithë prozën e tij më të mirë, atë epike, qëndron në ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet dy tipeve të shqiptarëve: shqiptarëve-Rrapo dhe shqiptarëve-Memo, ndërmjet dy brezave, burrave dhe të rinjve. Dhe këtu nuk ka rëndësi aspak se cilat modele mund të ketë pasur parasysh autori, kur skaliste të tilla karaktere. Në të vërtetë përvoja e tij jetësore ka qenë e mbushur me shembuj ngjarjesh dhe njerëzish të denjë për t'u marrë si modele. Këtu e rëndësishme është të kuptojmë madhështinë e sintezës dialektike - që Dritëro Agolli krijon nisur nga kjo përvojë e pasur e jetës, e vetë viteve të Luftës - ndërmjet burrit të drejtë por të palatuar (komandant Rrapos, kapedan Gurrës, Mato Grudës) dhe njeriut me formim të ri, shikimi i të cilit rrok jo vetëm tërë hapësirën e atdheut dhe botën përtej, por edhe të gjithë problematikën e shoqërisë shqiptare dhe problematikën e madhe të botës (komisari Memo, Murat Shtaga). E rëndësishme është të kuptojmë madhështinë e sintezës ndërmjet heroit popullor dhe heroit të mençur e të ditur, me horizont e largpamësi shoqërore.

Këtu qëndron arritja më e madhe e prozatorit Dritëro Agolli, prurja e tij më e vyer në letërsinë dhe, pse jo, në historinë e vendit. Te "Komisari Memo" lexuesi gjen një tablo realiste të kohës, një tablo, e cila pikërisht për shkak të funksionit të veçantë të letërsisë së mirë artistike në krahasim me letërsinë shkencore, funksionit për të rikrijuar artistikisht e me vërtetësi jetën, ndikon drejtpërdrejt mbi ndërgjegjen e lexuesit dhe, rrjedhimisht, e mbush atë më shpejt dhe në mënyrë më të qëndrueshme se veprat shkencore.

Pikërisht kjo dialektikë historike brezash të popullit tonë, kjo lidhje e tyre dhe vijimësi detyrash nga njëri brez te tjetri, ka luajtur një rol vendimtar në formimin e vetë Dritëro Agollit si qytetar dhe si krijues. Dhe kjo na shtyn të themi me bindje se ashtu si Shqipëria ka pasur fatin të përjetojë ngjarje të tilla të mëdha si Lufta Nacionalçlirimtare, po ashtu ka pasur fatin të lindë një këngëtar të tillë të papërsëritshëm të këtyre ngjarjeve, sikurse është Dritëro

Agolli.

Nuk gjenden lehtë në letërsinë tonë artistike pjesë të tilla të qarta - dhe të fuqishme, pikërisht sepse të qarta - si këto më poshtë (flet partizani Nurka):

"E di si thotë komisari ynë, Arif? Ai thotë se ne dimë të parashikojmë ngjarjet dhe të luftojmë në të gjitha konditat dhe me të gjitha mjetet, me armë e me gjykim. Borgjezia ruan xhepin e saj të ngopur. Borgjezia është gati të zhdrukë tërë botën e të therë mijëra e miliona fëmijë për të ruajtur këtë xhep dhe për të mbajtur në duar kamxhikun. Po ta kuptosh këtë, kupton edhe komunistët. Megjithatë tjetër është ta kuptosh dhe tjetër të veprash në të gjitha konditat dhe me të gjitha mjetet..."

Dhe (përsiatje të komisarit Memo):

"Lufta nuk kërkon vetëm kuptimin e së drejtës dhe të shtrembës, por kërkon edhe guximin, edhe vetëmohimin..."

Sigurisht "Komisari Memo" nuk është një veper e gjithmbarshme, një veper për të gjithë lexuesit. Në të vërtetë edhe vetë figura e Dritëro Agollit nuk është e gjithmbarshme, nuk është një figurë për të gjithë qytetarët e vendit tonë. Ky roman është aq më i pakuptueshëm për ata lexues, në vendet e të cilëve ose nuk ka pasur lëvizje antifashiste partizane ose ajo ka qenë fare e dobët.

Por romani "Komisari Memo" mbetet në galerinë e veprave tona

madhore letrare e kulturore, ashtu si busti prej bronzi i Memo Kovaçit zuri vend në gurin e madh në noç të fshatit.

10.

"Komisari Memo" në të vërtetë është një poemë në prozë për gjënë më të shtrenjtë të jetës së Dritëro Agollit, Luftën Nacionalçlirimtare dhe ideale të saj, punën vetëmohuese të një populli të tërë për t'i kthyer në jetë ato. Kjo gjë e lidh edhe më shumë e më drejtpërsëdrejti këtë roman-poemë me krijimtarinë poetike të Dritëro Agollit.

Krijimtari poetike, që përbën edhe thelbin e gjithë prurjes së paçmuar të D. Agollit në historinë e letërsisë dhe kulturës shqiptare, në vetë historinë e Shqipërisë, shquhet për të tilla vlera - të gjithanshme, të mëdha dhe të pavenitshme - sa me të drejtë ka gëzuar dhe gëzon nderimin e më të madhes masë të lexuesve shqiptarë të disa brezave. Pikërisht poezia, gjinia më e vjetër dhe njëkohësisht më e freskët e krijimtarisë artistike njerëzore, gjinia së cilës D. Agolli i falli energjitë më të mira të talentit të tij të rrallë, ia "shpërbleu" atij duke e kthyer në poetin më të dashur e më të lexuar të gjysmëshekullit të fundit për shqiptarët.

Nuk ka pothuaj asnjë krijim poetik të D. Agollit, që nuk mbart një tërësi mesazhesh - në ide dhe në zgjidhje formale, në mendim dhe në teknikë poetike - të cilat i flasin çdo zemre e çdo niveli

ndjeshmërie njerëzore. Nuk do të kishte përmbledhje poezish të tij, ku përzgjedhësi nuk do të ndihej ngushtë për shkak të krijimeve që do të ishte i shtrënguar të linte pa përfshirë. Dhe është pothuaj e pamundur të thuhet se cila poezi janë ndër më përfaqësueset e krijimtarisë së tij, ndër më shprehëset e shpirtit krijues të Dritëro Agollit.

Do të sjellim vetëm dy krijime në nderim të kësaj krijimtari praktike të përsosur. Dhe do të kërkojmë mirëkuptimin e lexuesve, nëse ata në mendjen e tyre ruajnë të tjera vargje e të tjera kumbime të D. Agollit.

"S'ka asgjë për të qeshur" (1984)

S'i kam dashur kurrë gjërat e bujshme
Dhe shpesh jam menduar duhan duke pirë;
Ka gjëra lakuriqe që s'janë të turpshme,
Siç ka dhe gjëra të çndershme të veshura mirë.
Ja, e vërteta rri lakuriqe ngaherë,
Ja, dhe gënjeshtria me petka rri veshur!
Më thon: cila ka turpin dhe cila ka nderë?
Kjo që ju thashë s'ka gjë për të qeshur!

"Guri" (1984)

Në fshatin tim prej vitesh s'kisha qenë
Dhe malli më kish djegur e zhu-



ritur,
Atje më dukej hëna tjetër hënë
Siç thosh dikur Naimi mendjen-
dritur:

Në çezmë ndala t'ia dëgjoja fjalët,
Që vetëm unë i merrja vesh aq mirë;
Por shkela në një gur të rrumbullakët
Dhe gjurin e dërrmova në errësirë.

E mora gurin në pëllëmbë qetë
Dhe thashë i lodhur, zhytur në mendime:
"Për pak të shava keq, o gur i shkretët,
Sikur mos ishe nga vendlindja ime!"

Por lexuesve, të cilët kanë kohë që janë çmësuar të lexojnë krijime të vyer poetike, të cilët në të vërtetë i kanë çmësuar të lexojnë letërsi të pastër, domethënë të bukur dhe të singërtë, të kujtuarit e Dritëro Agollit është rasti më i mirë për t'u sjellë në vëmendje atë që përbën boshtin e gjithë krijimtarisë letrare të autorit tonë të madh, poemat.

Pikërisht e si për çudi - po jo çuditërisht - poemat janë pjesa e krijimtarisë së D. Agollit, që më së shumti është lënë në harresë dhe që e përfaqëson më mënyrën më të thellë, më të qartë dhe më të ndritshme njeriun-krijues D. Agolli. Mospërmendja e poemave është dëshmi e tërthortë, por e sigurt se krijimtaria e D. Agollit i nënshtrohet në të vërtetë një censurimi të pashallur, me mënyra financiare në dukje, ideore në thelb. Ky censurim, nga ana e tij, është dëshmia më e dukshme e vërtetësisë së vargjeve të mëposhtme të D. Agollit ("Poema e njeriut të zemëruar", 1992-1994):

Rinia ime,
Mundohen të tjerët
Që unë dalngadalë të harrohem,
Të dal nga kujtesa e njerëzve
Ditë për ditë,
Që vargjet e mia gatuan në vite
Të trenen e të ftohen
Në raftet arkivash të fshehta...

Te poemat e Dritëro Agollit është dheu i lindjes dhe toka e bukës, është nëna dhe është babai, janë të parët. Te poemat është jeta me gëzime e halle, është puna dhe është lufta, familja dhe shoqëria, janë ëndrrat për të ardhmen e mirë këtu, në Shqipëri, e jo diku, ku doqoftë. Te poemat është jo vetëm pjesa më e mirë e D. Agollit, jo vetëm pjesa më e bukur e tij, por edhe thjesht pjesa më e lartë, më fisnike.

Vijon

S

SPROVA

Në këto sprova poetike autori shfaq mendimin e tij në formën e epigramave. Duket shqetësimi i kohës dhe përcjellja që ai i bën sipas mënyrës së vet...

Lutje njerëzve

NGA PRENG MACA

Lutje njerëzve

kur ngjiteni në pushtete

ju lutem ruajeni zemrën,
mbajeni me vete!

udhëtim

Det i trazuar, gjithë dallgë
ne jemi nisur për diku
vetëm udhëtimi...na shpëton!

Të gjithë jemi në anije.

Askush prej nesh nuk e di
kush është në...timon!

stinë

asokohe isha shumë i varfër,
vishja këpucë të riparuar,
e shihja këpucarën, si perëndi,
vrapiroja tek ai për riparimet e radhës,
duke ja shkelur syrin,
që të m'i bënte këpucët, si të reja
pasi i vishja,
nëpër takime e rrugë
vrapiroja si era.

iku ajo kohë,
tani kam këpucë të reja,
që më presin në radhë,
këpucë për xhiro, për verë, për dimër,
këpucë për tango
por drejt ta hajë
tani më vrasin... kallot.

mungesë

ndodhesh aq larg
aq e përkryer!
Dashuria ime...e kursyer!

shi

bie shi pa pushim
nën çadra ecim nxituar,
për ti ikur zemërimit të qiellit...

duke mbrojtur secili veten nën çadra
harrojmë...njeri-tjetrin!

zogj dhe xhama

Nga dera e hapur hyn zogu
i gëzuar se tashmë është ngrohtë
shpëtoi nga kulli përjashta.

Pas pak provon daljen
Nuk e gjen më derën
Xhamave të mëdhenj përplasat
Ose siç thonë rëndom njerëzit
"Vrau veten!"

rrugës

jemi gjithnjë të lirë
kur jemi rrugës.

Kudo qëndrojmë në vende fikse
Vetëm ndërrojmë...burgjet.

deti i munguar

Akuarium me peshq
Peshq në akuarium!

Pronari i akuariumit
Mashtron peshqit
Se, gjoja,akuariumi është...deti.

Larg prej dhomës gjëmon deti!
Po peshqit janë tashmë të shurdhër,
Janë të lumtur peshqit!(!)

vetmi

mos më lër vetëm!
Nga zemërimi yt
Bien çastete e mia të gëzuara
Si një pemë prej së cilës bien frutat
Prej erës së fortë,prej erës së tërbuar!

Mos më lër vetëm!

Ngajj brenda zenkave,
Si një fetus,
Me kokën në...duar

mbreti

Ai më tregoi,se rastësisht u panë
krejt rastësisht së bashku u njohën
ishite rasti fatlum dhe u deshëm
kësisoj rasti, pra, është Mbreti i botës!

Pastaj erdhi rasti dhe u ndanë
(sa keq ishte ndjerë pas ndarjes!)
E vërtetë, se prapë rasti është sërish Mbret
por kësaj radhe ishte një Mbret vrasës!

Instikt

Mos u tremb
në këtë jetë asgjë nuk humbim!

Nëse shpirti ynë,
e tradhton...trupin!

brishtësi

kur do që ta kapësh,kërcën si top
nga dyshemeja në tryezë.

kur bie poshtë,
rrezikohet të thyhet si një vezë.

përpëlitur në dëshira
zihem si në një lak, në...pendesë!

kob

në grykë e kam Atdheun tim
një dënesje, një parandjenjë, një si...kob!

mbeti deteve gjithë jetën
kurrë nuk u bë Kolomb!

Skeptikët

Ata rrijnë e vështrojnë vezën e çarë, habiten
me lëvizhjen
ndërsa mbi kokën e tyre shkon "ushtria" e
zogjve!

shtëpi

Mendimet e mia janë trarët,
çastet e fiksuara janë...çatia,
fjalët e shkruara janë...muret,
raportet me jetën e vdekjen janë...themelet,
ndërsa dashuria ime janë...dritaret!

Ju gjithnjë mund të shihni
çfarë ndodh në këtë shtëpi,
brenda së cilës gjendem i mbyllur,
nga mungesa e dyerve,
shkaktuar prej pavetëdijes!

për dashninë

sa do të kisha dashtë
me e vu kangën time për dashninë
e të shëndrrohej ajo në një...burim!

ndonjë ditë të mbrame,
të pijsh e etur ujin
e kohës së tashme
e të shihesh në atë ujë,
si në veten tandë!

varkat në fëmijëri

kur isha fëmijë e plot ëndrra
lëshoja mbi lumin e qytetit tim verior
varka prej letre,
mbi to shkruaja dëshirat e mia të shumta

aq shumë i kam dashur ato varka prej letre
e mendoj se ato akoma nuk janë mbytur
tashmë lundrojnë... nëpër dete!

sekret i lexueshëm

Ti je gjithnjë brenda meje
Siç rri shiu e fshehur pas një...reje!

ditë si një vezë...

ditë të rrumbullakta krejt si...vezë Pashke
trembem tek e mbaj në dorë,
mos bie dhe e thyej, pa dashje

e kriset, e thyhet
e përfshihemi të gjithë në...ngjarje!

antigjetje

Aq shumë e kërkuar, ti je gjëja e duhur
në këtë pyll të ngatërruar... gjetje e pamundur!

Ne jemi të hutuar dhe pafajësisht...të humbur!



Opinioni / i Ditës

Reformat, sfera publike dhe riorientimi i vlerave

Nga Elvis Zaimi

(vijon nga faqja 1)

... qenë të domosdoshme shumë kohë më parë, do të ndërmerren vetëm pasi sëmundjet shoqërore janë bërë akute, pra edhe nevoja për reforma e pashmangshme. Pikërisht për këtë arsye, një qeveri njëngjyrëshe socialiste, e vetdijshme për sfidën serioze me të cilën duhet të përballet, po përpjet të motivojë psikologjikisht popullin duke vënë në qarkullim dhe mbushur hapësirën publike me harenga idesh dhe shashka propagandistike të shumta, madje edhe në kurrit të sistemit demokratik, duke u përpjekur në këtë mënyrë t'i imponohet edhe sferës publike, e cila, sipas Habermas, nuk pranon forma shtrënguese dhe detyruese të komunikimit, por është e karakterizuar nga vetëreflektimi racional.

Me inkursionet dhe praktikatat e saj të komunikimit në jetën publike të vendit, qeveria nuk po kufizohet vetëm në shpjegimin racional të politikave që kanë lidhje me zbatimin e reformave, por duket se ka marrë përsipër ta shtyjë dhe orientojë shoqërinë drejt vlerave të saj. Në mënyrë paradoksale, një forcë politike e majtë, po përpjet të risinkronizojë sistemin shoqëror të vlerave kombëtare me vlerat perëndimore, duke shfrytëzuar për këtë qëllim dhe përdorur në avantazhin e saj, paaftësinë e qeverive të mëparshme për ta arritur këtë sinkronizim. Nëse kjo qeveri do të arrijë këtë risinkronizim, ky do të ishte një sukses kombëtar, dhe jo thjesht i Partisë Socialiste, por përvoja zhgënjyese e qeverive të mëparshme të tranzicionit, na obligon të jemi syçelë. Së pari, restaurimi i filozofisë politike nëpërmjet moralizimit të saj, është prova e parë e vullnetit të sinqertë që duhet të japë qeveria për të na krijuar besimin sesa premtesse drejt suksesit janë reformat që ka marrë përsipër. Manovrat cinike dhe manipuluese, të cilat realiteti shqiptar bizantin e politik ka prirjen e natyrshme t'i përsërisë duke i çuar drejt përsosjes, ndonëse mund të jenë efektive për hegemonizimin e pushtetit në periudhën afatshkurtër, rrezikojnë të sjellin në njëjtin efekt boomerang, siç ka ndodhur me qeverisjet e mëparshme. Përpjekjet e burokracisë për t'iu imponuar sferës publike janë një nga shkaqet e krizës së legjitimitetit demokratik të BE-së, ndaj joshja nga ideja se vetëm një forcë politike mund t'i japë legjitimitet jetësimit të vlerave etike në jetën publike të vendit apo programit të reformave, është antidemokratike. Vetëm debati racional publik ka të drejtën të vendosë standarde dhe norma të gjithëpranuar. Fatqësisht, diskutimi publik në Shqipëri, duke fil-



luar nga ai që zhvillohet në parlament, në shtyp, në transmetimet publike televizive dhe në segmente të tjera të sferës publike, është jo vetëm i deformuar, por polimorf, kakofonik dhe anarhik në vlerat dhe racionalitetin që mbart. Shtypi shqiptar vazhdon të jetë një komentues pasiv i komunikimit politik, kryesisht i dominuar nga komentimi i lajmit politik, sesa nga raportimi dhe analiza e saktë e tij. Pra, shtypi vazhdon të mbetet një ndërmytes mediokër ndërmjet politikës dhe qytetarit, duke dështuar të jetë pararendësi dinamik i progresit shoqëror.

Nga ana tjetër, kjo situatë e sferës publike shqiptare nuk mund të shërbejë si justifikim për qasje voluntariste të ekzekutivit nëpërmjet mobilizimit të masave, apo me shfaqje simbolike në publik të lidhura me menaxhimin e personelit nëpër dikasteret qeveritare, të cilat ngajnë më shumë me lëvizjet marksiste sesa me reformat e mirëmendura liberal-demokratike që sjellin rezultate të qëndrueshme në kohë, pikërisht sepse arrijnë të rregullojnë proceset ekonomike dhe shoqërore duke riorientuar vlerat, dhe riintegruar shoqërinë drejt tyre. Ky riorientim vlerash dhe shëndoshje e kohezionit social kërkon që objektivi final i reformës të ngrihet mbi një paradigmë të re, atë të ndërtimit të një administrate shtetërore demokratike, profesionale dhe në shërbim të politikave zhvillimore të vendit, politikisht neutrale, si dhe të një gjyqësori të pavarur dhe

të paanshëm. Anomalitë e funksionimit të administratës publike dhe korrupsioni i përhapur në radhët e saj nuk janë të lidhura thjesht me menaxhimin e personelit në varësi të vullnetit që dëshmojnë forca të ndryshme politike kur vijnë në pushtet. Diagnoza e këtyre fenomeneve bëhet mbështetur mbi logjikën e argumenteve racionale, të cilat dëshmojnë se parazitizmi dhe korrupsioni në administratë janë të formuara dhe konsoliduara historikisht gjatë gjithë ciklit të tranzicionit, pjesë e një kulture të shtrirë në të gjithë shoqërinë shqiptare. Këto fenomene sot janë të agravuara nga politikatat e dështuara të së kaluarës në menaxhimin publik, ndaj është detyrë e kësaj qeverie të riafirmojë vlerat dhe parimet që i hapin rrugë një perspektive më të mirë të së ardhmes.

Nga ky këndvështrim, të riorientosh vlerat shoqërore duke i sinkronizuar me ato evropiane është një gjë e ndryshme nga përpjekjet e maskuara për t'i diktuar jetës publike "vlerat" e tua, të cilat nuk kanë lidhje me demokracinë, sepse demokraci të diktuar nuk mund të ketë. Riorientimi i vlerave kërkon që qeveria të udhëheqë nëpërmjet shembullit, dhe të ballafaqohet seriozisht me degradimin e institucioneve dhe luftën kundër krimit ekonomik, që po shteronjë resurset kombëtare dhe kanë mbytur klimën e investimeve private, duke rrenuar besimin e shqiptarëve të tregu i lirë dhe shteti i së drejtës. Këto duhet të jenë prioritetet në agjendën reformatore, sepse janë tregues të drejtëdrejtë

se qeveria është sinqerisht e preokupuar për të mirën publike, për politika dhe aksion qeveritar që përmirëson jo vetëm kushtet shoqërore dhe ekonomike të jetës të qytetarit dhe fshatarit të thjeshtë, por edhe drejtësinë sociale. Nga ky këndvështrim, përqendrimi i kompetencës në ekonominë dhe financat publike në një dikaster të vetëm, duket jo vetëm një reminishencë e ekonomisë së komanduar politikisht gjatë regjimit komunist, por edhe e pafrymëzuar nga dëshira për reforma të sinqerta.

Në betejën reformuese të pushtetit gjyqësor, zhgani i gjyqtarëve paraqitet një kërcënim po aq i rrezikshëm sa edhe zhguni i politikës. Nëse politika shqiptare do të vazhdojë të zhvillohet dhe performojë nën standardet e një shteti modern, i cili aspiron të bëhet pjesë e një klubi vendesh të pasura si BE-ja, atëherë përpjekjet për reforma reale, d.m.th që sjellin përmirësime të qëndrueshme në kohë, do të mbeten një iluzion. Nëse besojmë Raz dhe Habermas, ajo që e dallon dhe shquan procesin e qeverisjes në demokracitë bashkëkohore, nuk është thjesht legjitimiteti që buron nga vullneti elektoral i shprehur nga shumica e popullit për të sjellë një forcë politike në pushtet. Më së shumti, themeli i legjitimitetit dhe çelësi i suksesit të politikave qeveritare që vihen në zbatim qëndron të përpjethja ndërmjet arsyeve të veprimtari qeveritar me arsyet dhe pritshmëritë e të mirës së përgjithshme, të formësuar në një hapësi publike të dominuar nga logjika e argumentit racional.

HOROSKOPI

DASHI

Hëna nuk shkon mirë me Plutonin në qiellin tuaj dhe në atmosferën që jetoni me atë që ju ka hyrë në zemër. Pakënaqësia prirret të mbizotërojë. Mos e vini në dyshim atë që ndjeni për partnerin që në zënkat e para që keni me të...

DEMI

Jeni përballë një zgjedhjeje të rëndësishme, por qëndrojeni zgjedhjeve të bëra më parë dhe mos hiqni dorë nga autonomia tuaj. Mos i lejoni një familjari t'ju pengojë. Do t'ia dinë të angazhoheni në nismat tuaja, duke prekur pikat e duhura emocionale.

BINJAKET

Marsi dhe Venusi ju mbështesin. Dashuria do të vazhdojë të ketë një rol shumë të rëndësishëm në jetën dhe mendimet tuaja. Do të përjetoji edhe anë e ëmbëla. Një vizitë tuaja, edhe pse e shkurtër, do të gëzojë një familiar apo një të afërm. Do të ndiheni të kënaqur.

GAFORJA

Keni nevojë të kaloni çaste të qeta. Largoni me takt persona që nuk janë shumë pozitive, të cilët ju marrin nëpër këmbë, dhe buzëqeshni jetës. Hëna bën që të provoni të zgjidhni një problem midis miqve, por nuk do ta keni të thjeshtë.

LUANI

Falë Uranit, Saturnit dhe Plutonit bashkëpunëtorë, perspektivat sentimentale janë të mira. Mund të nisni një histori pasioni, e cila mund të kthehet në një lidhje të qëndrueshme. Ndoshka në dashuri nuk jeni ende gatë për të ndërmarrë hapin madhor, por me siguri drejt asaj gjëje.

VIRGJERESHA

Për faj të Uranit kundër, nuk është rasti për të bërë beteja kundër mullinjve të erës. Prandaj mos e çoni ndër mend se mund të ndryshoni botën! Si zakonisht, mbi të gjitha për çështje pune, reagoni duke u mbështetur mbi vendosmërinë dhe saktësinë.

PESHORJA

Sot yjet nuk janë shumë të shkelqyeshëm. Do të shqetësoheni për çështje profesionale, të cilat do të dalin se nuk janë problematike! Në punë mos bini shumë në sy, rriti të qetë dhe shfaqini aftësitë tuaja në momentin e duhur.

AKREPI

Në familje do të keni disa kundërshime të shaktuara nga këndvështrimet të ndryshme. Mos u merrzisi, larmishmëria është gjithmonë diçka pozitive, që duhet shfrytëzuar për t'u ngritur. Falënderoni kolegët që ju rrin prapë duke ju dhënë ide dhe mundësi të mira.

SHIGJETARI

Për meritë të pozicionimit të Saturnit në lidhje me Henën dhe Diellin, do të përballeni me shpirtin e përshatjes në një ndryshim të papritur programi. Me një shtytje të mirë do të jetësoni projektet tuaja, duke tejkaluar pengesat.

BRICJAPI

Nën mbikëqyrjen e Plutonit, ditën e sotme do të vihen në pah ana më kokëfortë e karakterit tuaj. Mbasse mund të rikthehen zënkat të vjetra familjare. Nxitiimi mund të bëjë që të bëni gabime. Prandaj, përpara se të veproni, mendojeni mirë atë që do të bëni.

UJORI

Përpjetitë të mos keni besim të pakufishëm në burimet tuaja dhe përpjetitë të bëni me objektivë, nëse nuk doni që të përballeni me zhgënjime. Kujdesuni për shëndetin. Bëni veprimtari fizike dhe shëtitje në natyrë, edhe pse është një shtinë e ftohtë.

PESHQIT

Keni arsytet më të mira për të ndihmuar një familjar që të tejkalojë vështirësitë dhe pasiguritë. Në këmbim do të merrni shumë mirënjohje të sinqerta. Me Jupiterin në shenjë, do ta keni rrugën e hapur për të pasur veprimtari kulturore.

Opinion i Ditës

Bisedë rreth komplimentit

Nga Valbona Nathanaili

(vijon nga faqja 1)

... më i bukur që keni marrë? Mund të identifikoni kombësinë e atij që ka bërë komplimentin? Shkak u bë Fjalori i Gjuhës Shqipe, i cili për fjalën "kompliment", ka këtë përkufizim: Fjalë lavdëruese që i thuhet dikujt për t'i bërë qejfin; lajkë. Ndonëse teksti që i referohem është botim i vitit 2006, përkufizimi është shumë i thatë, ndërsa nënteksti duket sikur pasqyron një marrëdhënie të dyshimtë dhënës-marrës, një detyrim, thënë me synimin që në këmbim të marrësh diçka. Bindja për këtë shpjegim të shtohet edhe më shumë kur i drejtohem të njëjtit fjalor për të gjetur kuptimin e fjalës sinonime lajkë: lëvdatë e gënjeshtert ose e tepruar.

Fjalori anglisht i jep këtë kuptim: një vërejtje e sjellshme, që i drejtohet dikujt, nëpërmjet së cilës shprehet pëlqim me paraqitjen, vlerësohen cilësi të caktuara, ose aprovohet një veprim i kryer. Po të vazhdosh me krahasimin, në përkufizimin shqip, komplimentet janë fjalë, ndërsa në atë anglisht është fjali (vërejtje), pra një mendim i strukturuar me një qëllim. Sa u takon sinonimeve, edhe fjalori anglisht e përmban fjalën lajkë, por në një kuptim më të largët, përpjes që edhe vetë përkufizimi i lajkës është pak më i butë se ai që jep fjalori shqip.

Duke qenë një shoqëri e formësuar nga vendime e politika që merren nga meshkuj, të cilët na tregojnë se si duhet të perceptojmë e veprojme, që kanë vendimmarrje dhe na udhëheqin, - edhe autorët e Fjalorit të Gjuhës Shqipe janë të gjithë meshkuj - nuk është për t'u çuditur që përkufizimi i kësaj fjale ka mbetur i papërditësuar. Në një ekskursion të shpejtë nëpër grupe të ndryshme të shoqërisë sonë, nuk është vështirë të konstatojmë se "udhëheqësit" tanë meshkuj tregojnë se karakterizohen nga një mendësi e ngurtë, fiksur në koncepte e mendime që nuk promovojnë ndryshimin, të renë, progresiven, të ardhmen. Janë të mbushur me ndjenjën e hakmarrjes. Dhe me dëshirën për t'i bërë qejfin dikujt që ka në dorë diçka. Madhështia e tyre është në përpjesëtim të drejtë vetëm me hapësirën që përmban interesat e tyre personale. Jo shumë kohë më parë kam pasur një shef "të doktoruar jashtë", por "rebelin" që shihnte të një punonjës mashkull, e përkthente "në person që nuk pëlqen autoritetin" të një punonjëse femër: rebeli-mashkull i artikulluar me konotacione pozitive, femra që-nuk-pëlqen-autorititetin me konotacione negative. Ose që superioritetin e tij e ndërtonte duke bërë inferiorë njerëzit që e rrethonin.

Për këtë kategori njerëzish, përshatja me përkufizimin e fjalës "kompliment" në fjalorin shqip është perfekt. Ndryshe, ata nuk janë në gjendje të mendojnë një kompliment sipas përkufizimit të



fjalorit angliz. Thënë këto, besoj se meshkujt që na udhëheqin janë përjashtimi. Janë në krye, por nuk janë modeli.

Dhe kjo ishte një nga arsyt kryesore pse iniciova këtë bisedë. Arsyve po kaq kryesore ishte të provonim nëse ka vërtet mospërpjetë ndërmjet kuptimit që jep fjalori dhe kuptimit real, atë që kemi parasysh kur presim a japim një kompliment. Ndërsa synimi i dytë, por i bukur tashmë, është transmetimi i asaj ndjenje të mirë që të ngjall dhënia a marrja e një komplimenti. Bashkëbisedueset janë nga fusha e krijimitarisë, që arrijtjet i kanë në rrjedhojë të punës së palodhur e përpjekjeve, që më shumë se suksesi, i motivon përballja me sfidat, që janë të afta të spikatit, sepse janë bërë, pavarësisht se çfarë kanë trashëguar. I falënderoj singlerisht për përgjigjet dhe mesazhet që transmetojnë nëpërmjet tyre.

Mira Meksi, shkrimtare: Së pari mendoj t'i japim konotacionin e duhur fjalës "kompliment" sepse në shqip, në fjalorin e gjuhës shqipe, ka sinonimin e lajkës. Mendoj që ti i jep kuptimin që i jep tërë bota, domethënë një përgëzim për një cilësi, veprim, gjykim etj. Ndeshmëria ime më e madhe është të shkruajmë, së cilës i kam "shitur" shpirtin. Komplimenti më i spikatur që mbaj mend, ose që më ka prekur vërtet ka qenë nga kritika franceze, në vitin 1998, gjatë organizimit të Ditëve të Bukurosheve të Huaja në Francë, pra letrave shqipe, me pjesëmarrjen e 13 shkrimtareve shqiptare, mes të cilave isha edhe unë. Kritika letrare franceze shkruante se "...universi poetik i shkrimësisë së Mira Meksit është i mbushur nga magjia e autorëve të mëdhenj të

Mira Meksi, shkrimtare: Së pari mendoj t'i japim konotacionin e duhur fjalës "kompliment" sepse në shqip, në fjalorin e gjuhës shqipe, ka sinonimin e lajkës. Mendoj që ti i jep kuptimin që i jep tërë bota, domethënë një përgëzim për një cilësi, veprim, gjykim etj. Ndeshmëria ime më e madhe është të shkruajmë, së cilës i kam "shitur" shpirtin.

Duke qenë një shoqëri e formësuar nga vendime e politika që merren nga meshkuj, të cilët na tregojnë se si duhet të perceptojmë e veprojme, që kanë vendimmarrje dhe na udhëheqin, - edhe autorët e Fjalorit të Gjuhës Shqipe janë të gjithë meshkuj - nuk është për t'u çuditur që përkufizimi i kësaj fjale ka mbetur i papërditësuar.

Amerikës Latine, si Borges, Cortazar, Marquez, autorë që ajo vetë i ka sjellë në shqip. Filozofia e Borges-it, apo karakteri barok i personazheve të Marquez-it shënjojnë identitetin e saj ballkanas". Kjo, përveç se në shtypin francez të kohës, gjendet edhe në botimin e Centre National du Livre (13 ecrivains d'Albanie) Paris, 1998.

Viola Isufaj, shkrimtare, studiuese: Në përfundim të një interviste, më quajtën "Dolce Diva", ndërsa në fundin e një fraze, në një letër që kam marrë kohë më parë, shkruhet: "...këtë bukuri që e pashtë me sytë e mi!" (Kombësia në të dyja rastet është shqiptare).

Eleni Laperi, studiuese dhe kuratore arti: Komplimentin që më ka miklluar më shumë e kam marrë nga një grua e thjeshtë, një taksiste në Iowa, ShBA. Pak përpara se të zbrisja, m'u drejtua: "Mos jeni artiste? Pse mendoni se jam?" - e pyeta. Sepse si ty, këtu, vetëm artistët dinë të rrinë."

Sonila Kapidani, Specialiste Edukimi në Teatrin e Metropolit, Qendra Kulturore Tirana: Natyra e punës sime është e tillë që marr shpesh komplimente sepse jam në komunikim të drejtpërdrejtë me njerëz të grupmoshave të ndryshme, të cilat i vlerësoj si rimbush-

ashtu, mendoj se spektri është pak më i gjerë dhe brenda fjalës "kompliment" ne shprehim edhe përgëzim, edhe inkurajim, edhe solidarizim, edhe admirim për personin që ia drejtojmë. Zgjidhjen e bëra mbi dy kritere: në funksion të njerëzve që i kanë thënë dhe në funksion të sa mirë më kanë bërë të ndihem. Koha është pak e largët. Isha në klasë të 8-të dhe sapo kisha ndërruar shkollën. Asnjëherë nuk i kam pasur shumë të mira marrëdhëniet me shkencat e sakta. Por në shkollën e re, mësuësja e matematikës zbuloi - mua m'u duk si me magji - një prirje për këto shkencat. Zbulim i madh, sepse fill-oja të ndihesha vërtet e zonja. Një ditë, po kjo mësuësja, Shpresa (ka kohë që nuk jeton më), ndërsa na dha një detyrë për të zgjidhur në klasë, afrohet pranë bankës. Si me shaka, shoku i bankës, Alberti, i thotë për mua: "Mirë, mirë, dakord me matematikën, por nuk është dhe aq e bukur!" dhe mësuësja Shpresa, me një ton të ëmbël, i përgjigjet: "Nuk prish punë, ajo ka mendjen të bukur". Këto fjalë u gdhendën në kokën time.

Rudina Çupi, poetë: Komplimenti është i përkohshëm e ka vetinë të harrohet shpejt - sidomos në rastet kur ka të bëjë me dukjen e personit a të punës apo kur është përshkrimi e momentit. Por, mbetet vlerësim, qoftë ose jo i thellë dhe ka aftësinë të të bëjë të ndihesh si jo mirë, sidomos kur është i vërtetë dhe i ndierë. Me pak fat e mençuri mund të mbash rreth vetes njerëz me shpirt të bukur, që e mbajnë të gjallë atë si shpizë e vjetër për të ndezur zjarre të reja arrijtjesh e gëzimesh. Sa herë kam njerëz për mbështetje, mbaj të gdhendur në mendje dhe e kam shumë për zemër vlerësimin e "babit tim shpirtëror" (shqiptar): "Edhe kur unë të mos jem pranë e të ndiesh se ke nevojë të jem aty për të të mbështetur, dije se ti je atmosferë - jetëdhënëse, e epërme, në zhvillime të vazhdueshme e të furishme - po të cilën një burrë ndihet i shkretë, si çdo planet tjetër".

Valbona Nathanaili, studiuese, përkthyes: Në sistemin tonë shkollor ka qenë traditë që çdo të premtë të fundit të muajit organizim takime me prindër. Duhet të ketë qenë fillimi i viteve 1990, sapo kishte filluar lëvizja e lirë dhe një takim, njëra nga vajzat që kisha në klasën në kujdestari, krahas së emës, shoqërohej edhe nga një italiane. Mbas përshkrimit të arrijtjeve të nxënës sime, i kërkova italiane të më shpjegonte diçka në lidhje me këto lloj takimesh në sistemin arsimor italian. Por mbyllja e takimit, për mua, ishte edhe më e bukur se hapja. Duke më dhënë dorën, italiane m'u drejtua me këto fjalë: "Po të kisha një mësuësje të tillë, nuk do e kaloja kurrë klasën". Në fund të asaj dite, padashur, m'u kujtova edhe një herë italiani, por gjithnjë me buzë në gaz. Dhe e kujtoj thjesht si italiani. Fakti që kam veçuar një të huaj, si njeriun që më ka bërë komplimentin më të bukur, ishte shtesë për ta shtuar në grupin e pyetjeve që u drejtova kolegeve.


je energjie, si pamje e vetes sime se u duhem njerëzve e si mënyrë për të pasuruar veprimtarinë e mëtejshme. Po veçoj një kompliment që kam marrë tani së fundmi, e personat që e artikulan janë bashkëkombës: "Po të kishte bota me shumë njerëz si ti, do ishte vend shumë i bukur për të jetuar", - që e sjell në mendje sa herë ndiej shterim!

Burbaqe Spahiu, producente, Drejtore Ekzekutive "Shoqata Kulturore Shqipëri - Kinë (ACCA)": Të rrëfij për komplimentin më domethënës? Ok! Pa dyshim është ai që më ka drejtuar Ismail Kadare. Po afroheshin festat e fundvitit. Në një mbrëmje të bukur dhjetori, nga ato që vetëm në Tiranë mund të gjejsh, shëtisnim bashkë me Ilin, bashkëshortin tim në bulevard. Isha veshur me pelicë të shkurtër të zezë dhe kisha vënë kapuç të bardhë në kokë. Rastësisht takojmë Kadarenë. U përqaftua për zemërsisht, ai u kthye i tëri nga unë dhe më tha i entuziazmuar: "Je gruaja që i shkon dimri". Këtë kompliment e ka shkruar edhe në dedikimin në faqen e parë të librit "Kukulla".

Ada Çapi, shkrimtare, farmacistë: Komplimentin më të bukur mund të them se ma ka dhuruar im bir, adoleshent, 15 vjeç. Ka shumë dëshirë të dalim bashkë. Një herë më tha edhe arsyen: "Të flasim për gjërat e mia sekrete".

Blerta Hyska, përkthyes: Për mua zgjedhja ishte e vështirë, m'u duk sikur duhej të zgjidhja ndonjë problem. Nuk kam frikë nga të dukurit vanitoze, ose edhe sipërfaqësore; qenia njerëzore është ndërtuar kështu dhe nuk besoj se ekziston njeri që nuk i është bërë qejfi nga komplimentet që ka marrë në situata të ndryshme. Gjith-

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ishte dekrét i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiquajt Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoërin.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë
34. Janë nofka.
38. Satelit i Jupiterit.

39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstreme në sirtar.
45. Kështu shtë lojtar i under 21.
47. Eshhtë gjuajja personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.

VERTIKAL

1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë temperuraturat më të ulëta.
5. Inicialet e Lendl.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisorë.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishte gjuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërëbimet me... korrespondencë.
17. I vihet kalit.
18. Rrapi i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorezë.
21. Eshhtë periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisor.
37. Parajsja e humber.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatikë.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë skllavëri.
16. Eshhtë shtypji për përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marfete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuesit.
32. Skuadra merengue.

VERTIKAL


33. Eshhtë trofet që fitohet.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshe.
39. Qetësonte detin.
42. Kanë dhoma që zihen.
44. Eshhtë ekulibri në palestër.
46. Në krye të jurisë.
47. Numri i kuartetit.
48. Gjysmë armate.

VERTIKAL


9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turmin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazil.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			3	5		2	9		
		8	4		6		7		
	5	6	9			8			
5				2	9				3
2		9				6			4
1			6	3			5	2	
		3			7	5	6		
	9		8		3	1			
	7	2		9	1				8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar


4	1	6	2	3	8	5	7	9
5	3	8	7	4	9	1	6	2
2	7	9	5	1	6	3	4	8
6	8	1	3	2	7	9	5	4
7	9	4	8	5	1	2	3	6
3	5	2	9	6	4	7	8	1
9	6	3	4	7	2	8	1	5
1	2	5	6	8	3	4	9	7
8	4	7	1	9	5	6	2	3

Argëtim filozofik

- "I mundur nuk është ai që humb, por ai që dorëzohet".
 - "Vullneti është ai që të bën të fitosh atëherë kur logjika të thotë se ke humbur".
- Carlos Castaneda**
- "Ashtu sikurse ata që ecin në diell ndiqen nga hija e tyre, kështu dhe ata që janë njerëz me vlera ndiqen nga lakmia e të tjerëve". **Sokrati**
 - "Njeriu gjeni mund të qeshë me gjithçka, ndërsa njeriu logjik nuk mund të qeshë gati me asgjë".
- Gëte

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A
D	I	A	N	A	H	A	N	T	I	K	
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	S
P	E	I	T	A	R	I	F	A	O	L	E
T	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E
		K	E	N	E	T	A	O	R	A	E
P	A	U	L	I	N	R	R	I			
A	K	E	O	T	A	A	D	I	D	I	M
R	U	M	U	N	E	A	I	E	R	A	
E	T	I	T	E	R	T	A	M	A	N	
I	N	T	E	I	G	O	R	D	I	A	N
I	N	T	A	R	O	M	A	T	I	T	
P	A	B	M	E	L	E	R	G	O		
R	K	U	P	A	E	M	I	R	A	T	E
O	H	A	R	A	A	R	O	M	A	T	
		C	I	K	L	I	S	T	E	T	
S	T	A	D	I	U	M	E	T	A	P	E
D	I	K	A	S	T	E	R	E			
K	E	N	T	N	G	O	P	J	E	V	
K	A	T	I	A	S	T	E	E	S	E	
A	R	T	I	N	I	O	L	A	T	E	
M	A	S	I	M	O	Z	A	N	O	R	E
A	M	A	N	I	A	N	A	N	N		
T	E	R	R	E	N	I	E	I	N	E	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

- Aroma e luleve nuk shkon kundër erës, as i Jaseminit, aroma e të mirëve shkon kundër erës: një njeri i drejtë njihet anë e mbanë.
- Kujdesi shpie në përjetshmëri, moskujdesi në vdekje; të kujdeshmit nuk vdesin kurrë, të pakujdeshmit janë si të vdekur.
- Sokrati: Lumturia është dhunti e natyrshme, mjerimin e shkaktojnë mungesat artificiale.
- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta.
- Asgjë nuk është më e shtrenjtë, se sa ajo që blihet me lutje. !

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

